

Xhafer Durmishi
SKENDER

VEPRA

6



PA TAKTIZIME

Xhafer Durmishi

1. Faridin Tafallari
2. Si nuk më njihke? - Jam nipi i Dajës Ramadan
3. E marrë me mend se ç'mundime ke pasur
4. Lëvizjes në Kosovë t'u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit"
5. Mendime të urta dhe të njerëzishme
6. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë
7. MEGJITHATË TË SHPALLUR SI AKT TË KRYER
8. Pa këto gjynahe që i mvishen në roman
9. DERI NË ÇASTIN E VDEKJES
10. BISEDIMET JANË ZHVILLUAR NË "ÇERDHEN" E SHOKEVE JUSUF E BARDHOSH
11. NGA DY NE NJË TË VETME
- Formimi i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ)
12. Gabimi strategjik i strategut
13. Komunikata e Bashkimit e botuar në Zëri i Kosovës, nr.1, qershor 1982
14. Nacionale apo klasore

15. Formimi i Qendrës Ekzekutive në Ludwigsburg
16. PA TAKTIZIME
17. Çdo hap tjetër mund të ketë pasoja të këqija
18. SA MË TEPËR TAKTIZIME ME TË PABESIN GJER NË FUND
19. Diskuto me ata tek të cilët ke ndërmend të mbështetesh më shumë
20. Qarkore interne lidhur me rastin e ish-PKMLSHJ
21. Kërkesa ime (Xhafer Durmishit) për dorëheqje nga Qendra Ekzekutive më 10 korrik 1983
22. STATUT I LEVIZJES PER REPUBLIKEN SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI
23. LUFTËTARI MË BESNIK DHE I PABESI GJER NË FUND
24. RROFTË LRSHJ - LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!
25. Themelet e Programit
26. NEGLIZHIM I RËNDËSISË AQ PARIMORE
27. DUHET PËRFUNDMISHT TË INFORMOHEMI
28. DALIN NGA KOMUNIKATA PËR BASHKIM

1. FARIDIN TAFALLARI

KUR LEXON NJË LIBËR TË NJË SHOKU TË VËRTETË
...ME TË VËRTETA...DHE MBI TË VËRTETËN...!!!

Nuk mund të rrija pa e përshëndetur duke i uruar shëndet e suksese kur ndihesh mirë, madje në vetvete të ndjesh një lloj krenarie që, ka shokë të vërtetë, që shkruajnë të VËRTETËN dhe mbi të VËRTETËN, e cila është tepër e domosdoshme në ditët e sotme, të trazuara, ku e vërteta, shpesh po tjetërsohet, ndonjëherë edhe me një qëllim të mbrapshtë!?

Sapo e lexova edhe librin e pestë, PA TAKTIZIME, të shokut dhe bashkëveprimtarit të ngushtë të JUSUF GËRVALLËS, dhe njëherit edhe shokut e bashkëveprimtarit tim, të atyre viteve të stuhishme, Xhafer Durmishit, një nga ata shokët e rrallë e të veçantë, atdhetar e patriot besnik, intelektual i zgjuar dhe i matur. ...U njoha me Xhaferin, kur shkoja tek i Madhi Jusuf Gërvalla, në Untergruppenbach... atje e takova këtë shok, shok të vërtetë, që për një kohë të shkurtë e tregoj veten se, ai i mbeti besnik dhe shok mëse i vërtetë i të MADHIT JUSUF!!!

Ja, LEXUES I NDERUAR...edhe koha si dëshmitarja më e drejtë, pa hile, e tregoi për JUSUFIN, YLLIN E PAVDEKËSISË, SHOKU I VËRTETË, se kush ishte, Xhafer Durmishi për TRIMIN e PAHARRUAR, por edhe për mua!... Ndihej mirë, ndihem krenar...i gëzuar, që ky bir shqiptarie po shkruan, po analizon veprimtaritë tona patriotike, aktivitetin tonë atdhetar, të atyre viteve të vështira, të asaj rruge plot sakrifica, ASHTU SIÇ KA QENË NË REALITET, me fakte dhe te dokumentuara, por ndihem akoma më mirë, sidomos, kur shoku im Xhaferi shkruan me aq vërtetësi për figurën, personalitetin, idealin, veprimtarinë patriotike dhe atdhetare të JUSUF GËRVALLËS, të veprës së TIJ të pavdekshme, madje edhe duke u bazuar në vete veprën e lënë nga JUSUF I MADH!!!.

Xhaferit, shokut e mikut tim i uroj shëndet e gjithë të mirat, që të vazhdojë dhe më tutje vepra të tjera, ashtu si e kam thënë edhe nëpër shkrimet e mia, qoftë në librat e mi apo dhe në shkrimet e publikuara nëpër faqet e internetit, se kurrë nuk është mjaft të shkruash për Jusuf Gërvallën.

FARIDIN TAFALLARI

2. SI NUK MË NJIHKË? - JAM NIPI I DAJËS RAMADAN

Ibrahim Kelmendi: "Mirani e njihte Fekir Dalenën, nga fshati Kodërnajë i Deçanit, qysh kur ishte në Kosovë. Deri në fund të viteve të 60-ta, formalisht ky ishte i punësuar në Postë të Pejës, por realisht punonte për UDB-në. Me rënien e Aleksandër Rankoviçit, Ministrit federativ të Punëve të Brendshme, edhe Fekirin e përjashtojnë nga puna në Postë, meqë po akuzohej si bashkëpunëtor i Vuj Radiçit, shef UDB-së në Pejë." (Atentatet, f.74)

I. K: "– Ju kërkohet juve, Zotëri Fekir Dalana, – iu përgjigj sërish me qetësi të madhe Mirani.

– Unë nuk jam Fekir Dalana dhe juve nuk po ju njoh fare! – foli ai pa mundur ta fshihte gënjeshtren e tij naive.

– Si nuk më njihke? Jam nipi i ish-kolegut tënd, Dajës Ramadan. Tani sigurisht po të kujtohem." (Atentatet, f.75)

Ibrahim Kelmendi: "Në Mynhen jemi duke u përpjekur të marrim Klubin "Rilindja". Ai vazhdon të jetë nën tutelën e konsullatës jugosllave. Aty ka qëlluar djali i Dajës Ramadan, Gariçi, kryetar, për të cilin ke dëgjuar." (Atentatet, f.191)

Ibrahim Kelmendi: "Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësimin se atë "**raport**" nuk e ka shkruar fare Jusufi, meqë nuk është në fahun, në germën dhe në frymën e tij. Po ta kishte shkruar vërtet ai, nuk do të ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant." (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.115)

Jusuf Gërvalla (**RAPORT**): "Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. ...

Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen." (www.albaniapress.com, 2 tetor 2011; Faridin Tafallari, Kur Jusuf Gërvalla shkruante)

3. E MARRË ME MEND SE Ç'MUNDIME KE PASUR

Jusuf Gërvalla: "E marr me mend (e kjo spikat edhe në letrën tënde) ç'mundime ke pasur të më shkruash në "nivele" tim, sikur. thua se vetëm në "nivele" tim të shkrimit paska për mua afim, respekt e dashuri për njerëzit! E çka do të kish qenë "nivele" im, sikur t'u jepej flirteve absurde narcisoide me vetveten dhe të injoronte faktin, se ka pa numër virtyte të tjera, që mund ta marrin vizën e njerëzisë para se një aftësi mesatare e të shkruarit?! Ky është ofendimi më i madh, që më ke bërë ndonjëherë: të më zhveshësh nga gjithçka njerëzore dhe të më identifikosh me një aftësi gati-gati mediokër të shkrimit! (Ti këtë se thua konkretisht, po del nga qëndrimi yt.)" (Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 282)

4. LËVIZJES NË KOSOVË T'U JEPET LIDHJA ME PËRFAQËSUESIN E "BASHKIMIT"

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të kemi nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së paku përsa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, nuk ekziston përshtypja

për organizim të mirëfillte dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t'u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së shën i Xh. D.), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë. Këshilla për ndërprerjen e marrëdhënieve me të kam pasur edhe nga ana e diplomatëve shqiptarë në Vjenë. (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981, (Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 266)

"– Si nuk më njihke? Jam nipi i ish-kolegut tënd, Dajës Ramadan."

Ibrahim Kelmendi: "Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësimin se atë "**raport**" nuk e ka shkruar fare Jusufi, meqë nuk është në fahun, në germën dhe në frymën e tij. Po ta kishte shkruar vërtet ai, nuk do te ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant." (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.115)

Jusuf Gërvalla (**RAPORT**): "Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. ...

Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen." (www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

5. MENDIME TË URTA DHE TË NJERËZISHME

"– Si nuk më njihke? Jam nipi i ish-kolegut tënd, Dajës Ramadan."

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit)." (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451)

6. EDUKATA IME S'MË LEJON TË VEPROJË NË MËNYRË TË TILLË.

Jusuf Gërvalla: "Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. Shokët e tu të rinj e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme. Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij." (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 411-412)

"– Si nuk më njihke? Jam nipi i ish-kolegut tënd, Dajës Ramadan."

Ibrahim Kelmendi: "Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësimin se atë **"raport"** nuk e ka shkruar fare Jusufi, meqë nuk është në fahun, në germën dhe në frymën e tij. Po ta kishte shkruar vërtet ai, nuk do të ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant." (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.115)

7. MEGJITHATË TË SHPALLUR SI AKT TË KRYER

Jusuf Gërvalla: "Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne. E vërteta është krejt ndryshe. Shoku Z. i ka procesverbalet e takimit me të. Po deshtët të ngulni këmbë edhe më tej në qëndrimin "antikomunist" të atij shokut të Lëvizjes, urdhëroni e bëjeni këtë punë në baza më të shëndosha e më të ndershme, merrini përbazë procesverbalet e takimit. **Atje shihet se ku qëndron e vërteta për bashkimin e paarritur, e MEGJITHATË TË SHPALLUR SI AKT TË KRYER në thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!"**, të cilën ndoshta nuk e ke pasur në dorë, ngase botimi i saj u spostua pas letrës sime dërguar shokut Z." (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 412)

"– Si nuk më njihke? Jam nipi i ish-kolegut tënd, Dajës Ramadan."

Jusuf Gërvalla (**RAPORT**): "Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. ...

Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen." (www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

8. PA KËTO GJYNAHE QË I MVISHEN NË ROMAN

U VRANË TRE EMIGRANTË

Sipas kumtesës së policisë këta janë Bardhosh e Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka

Bon, 18 janar - (TANJUG)

Policia e Shtutgardit kumtoi se gjatë natës së kaluar në vendin Untergruppenbah, afër Hajlbronit, në Krahinë Baden-Virtemberg u vranë tre emigrantë me prejardhje jugosllave. Këta janë Bardhosh Gërvalla (31), Jusuf Gërvalla (36) dhe Kadri Zeka (28).

Policia ende po i gjurmon dorasit, por mund të supozohet se është fjala për qerim tipik hesapesh midis emigrantëve të nëntokës së RFGJ, të cilëve, siç mendon policia i kanë takuar edhe viktimat e kësaj përleshjeje. Ky supozim jipet nga rezultati i parë i hetimeve të policisë, i cili nuk është definuar në mënyrë plotësisht të qartë, por që është mjaft indikativ. Konsiderohet në të vërtetë se "fjala është për krim me prapavijë politike", sepse ndërmjet emigrantëve të këtij lloji të orientuar armiqësisht ndaj Jugosllavisë, ka më shumë "rryma" dhe "grupacione".

Bardhosh e Jusuf Gërvalla, siç merret vesh, janë vëllezër. Ata tash, sipas të gjitha gjasave, janë bërë viktimë të mesit, të cilit i kanë takuar. Viktimë e tretë, Kadri Zeka, siç pohon policia, para kësaj, ka jetuar në Zvicër, ku ka pasë marrë azil. Nuk ka dyshim se të vrarët tash një kohë të gjatë kanë jetuar në RFGJ.

Policia e Shtutgardit kumtoi se ka organizuar ndjekje përmasash të gjera për zënien e vrasësve të mundshëm.

Qeveria e Bonit, siç deklaroi përfaqësuesi i saj për shtyp, e dënon rreptë vrasjen e tre personave. Ky përfaqësues shtoi në konferencën për shtyp se "qeveria shpreh keqardhje për shkak të përleshjeve të tilla." (Rilindja)

*Ibrahim Kelmendi: "Edhe për **Rezilën** ndjej keqardhje,... ..edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..." (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007)*

9. DERI NË ÇASTIN E VDEKJES

Syzanë Gërvalla: "BIOGRAFI E JUSUF GËRVALLËS

Jusuf Gërvalla është lindur me 1 tetor 1945 në fshatin Dubovik të Komunës së Deçanit në Kosovë. Prindërit e tij janë Bardhosh Gërvalla (1885) dhe Ajshe Gërvalla (1919).

Shkollën tetëvjeçare dhe të mesme i ka kryer në Pejë, ndërsa studimet e larta pranë Fakultetit Filozofik, dega Gjuhë e Letërsi Shqipe në Prishtinë. Më pas ka kryer edhe studimet pasuniversitare në fushën e letërsisë po në Prishtinë.

Në shkurt të vitit 1967 martohet me Syzanën (Shoshi) dhe lindin fëmijët Premtoni (1968), Donika (1971) dhe Ergoni (1977).

Nga viti 1972 deri më 1979 ka punuar si gazetar dhe përkthyes në Shkup në Gazetën "Flaka e Vëllazërimit" dhe në Prishtinë në Gazetën "Rilindja".

Gjatë kësaj periudhe ai boton një varg veprash letrare si: "Fluturojnë e bien" (Poezi) 1975, "Kanjuhë e Verdhë" (Poezi) 1978, "Shenjat e shenjta" (Poezi) 1979, "Procesi" (Dramë) 1981, "Rrotull" (Roman) 1984 (botuar pas vdekjes) etj.

Ai ka qenë gjithashtu edhe anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës dhe anëtar i Shoqatës së Përkthyesve të Kosovës.

Aktiviteti i tij ilegal e ka zanafillën qysh para demonstratave të vitit 1968. Në vitin 1975, ai pranohet anëtar i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ), e cila punonte ilegalisht.

Fushata e arrestimeve në vitin 1979 nuk e kurseu as Jusufin. Por, ai arriti t'u shpëtojë kthetrave të policisë serbe dhe emigroi në Gjermaninë Federale, ku i punonte edhe i vëllai, Bardhoshi. Pak më vonë i bashkohet edhe familja. Si drejtues i Komitetit të LNÇKVSHJ për Evropën Perëndimore ai zhvilloi një sërë aktivitetesh mjaft të rëndësishme. Ai organizoi dhe udhëhoqi demonstratat shqiptare në Perëndim, botoi dhe udhëhoqi revistën patriotike "Lajmëtari i lirisë" etj.

Ai ishte gjithashtu edhe anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të Kosovës të vitit 1981 ai zhvillon aktivitet edhe më të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu **DERI NË ÇASTIN E VDEKJES.**

Jusuf Gërvalla u vra më 17 janar 1982 në Untergruppenbach të Gjermanisë, së bashku me vëllanë e tij Bardhoshin dhe shokun e luftës Kadri Zekën. Ata u vranë nga dora gjakatare serbomadhe." (Suzana Gërvalla; E shpërndarë nëpër rrethe aktivistësh)

ÇASTI I VDEKJES

Donika Gërvalla: "Jusuf Gërvalla, i cili ishte i vetmi që nuk vdiq në vendin e ngjarjes do të deklaroj më vonë se nuk pranon të hyj në operacion pa dhënë një deklaratë. Në këtë deklaratë ai akuzon shërbimin e fshehtë jugosllav si autor të këtij atentati.

Jusuf Gërvalla vdes nga plagët e marra më 18 janar 1982 rreth orës 3 të mëngjesit." (www.gervalla.org, 2007)

Faridin Tafallari: *"Suzana: A pe ndonjë njeri?"*

Jusufi: Po e pash një njeri me trup të gjatë po nuk munda ta njoh. Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. AMANET po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot." (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Suzana Gërvalla: *"Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu DERI NË ÇASTIN E VDEKJES."* (Biografi e Jusuf Gërvallës)

Nga fjalët e gruas dhe bijës së Jusufit dokumentohet se Jusuf Gërvalla vdes më 18 janar 1982 rreth orës 3 të mëngjesit, **në atë ÇAST dhe PËRJETËSISHT**, si anëtar i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi dhe si Kryeredaktor i "Zërit të Kosovës". Lëvizja e Jusuf Gërvallës dhe Zëri i Jusuf Gërvallës, falë veprës së tij, përjetësisht i mbijetuan atentatet e UDB-së në të gjitha format e saj.

10. BISEDIMET JANË ZHVILLUAR NË "ÇERDHEN" E SHOKEVE JUSUF E BARDHOSH

Ibrahim Kelmendi: "Sa u përket individëve që luajnë këtë "lojë" dhe PKMLSHJ, nuk kam nevojë të ndalem, pasi edhe nuk më është kërkuar të di. Besoj se shokët Salih e Fahri dinë dhe kjo do ndihmonte. Them këtë, pasi "trajnerët" e ekipës janë sjell shumë në atë teren, bile e **kanë patur si "çerdhe"...** banesën e shokëve Jusuf e Bardhosh, ndër ta kryesisht Nuhiu, i cili shfrytëzoi në maksimum oportunitetin dhe naivitetin e disave...

Për shpjegim, kur ishim për bisedime me shoqen B. të shokët, në shtëpi të shokëve Jusuf e Bardhosh, se në cilin nivel dhe si duhet të bashkpunojmë për ta vazhduar luftën, ashtu siç ishte bashkpunuar përpara, ishin të pranishëm, - jo vetëm të pranishëm, por mund të thuhet edhe dirigjues..., - Nuh. (Nuhi Sylejmani) dhe Nexh. (Nexhati - Osman Osmani, siç e quanin atë tip të mbyllur e të heshtur...). Unë nuk munda ta kuptoj se Nexh.- Osman Osmani ishte i PKMLSHJ. Krijova bindjen se ishte kuadër i ri, i dërguar nga brenda nga LN... (LNÇKVSHJ) dhe siç më dukej, nga disa shokë të rinj dhe fare të paeksperiencë (të cilët gjithë kohën silleshin andej...) ky Nexh., sa për Nuh. të mos flasim, kur ai bënte ç'të donte..., dëgjohej shumë.

Potencova këtë rast, nga frika se mos gjatë **bisedimeve, nëse janë zhvilluar aty dhe nga ata që gjendeshin aty, të mos u ketë lëshuar ndonjë shpëtim (më 17 shkurt)**, që të kenë mundësi të thirren "në emër të tyre", pasi edhe gjendja ishte shumë, ta quaj specifike." (Letër Qendrës Ekzekutive, 30 qershor 1983, faqe 2)

11. NGA DY NË NJË TË VETME - Formimi i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ)

"D O K U M E N T

Nga mbledhja e përbashkët në nivel të përfaqësuesve të KQ të LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ

Në orën 21.10 të datës 17 shkurt 1982 (në Ankara – vërejtja ime) filluan bisedimet për bashkimin e organizatave motra, LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ, gjegjësisht për shkrirjen e këtyre dy organizatave në një të vetme.

Organizatën e LNÇKVSHJ e përfaqësojnë anëtarët e KQ (Komitetit Qendror-shën. im) Mërgimi (Sabri Novosella) dhe Shpendi (Xhafer Durmishi).

Organizatën e PKMLSHJ e përfaqësojnë Kushtrimi (Abdullah Prapashtica) dhe Halimi (Osman Osmani), anëtar të KQ. Në këtë mbledhje merr pjesë edhe anëtari i KQ të PKMLSHJ Qemali (Faton Topalli) si përfaqësues i këtyre bisedimeve.

Pas afër tre muajsh bisedime dolëm me propozime konkrete.

*Përfaqësuesi i PKMLSHJ Halimi (Osman Osmani) doli me këtë propozim; të bëhet shkrirja e dy organizatave në një të vetme me emrin **"LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI" (LRSHJ).** " " (Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë, 1997, faqe 217 dhe www.pashtriku.org, 2008)*

12. GABIMI STRATEGJIK I STRATEGUT

Një dokument i kohës në të cilin përshkruhet puna prej 18 janarit 1982 deri në korrik 1982, e sidomos përjashtimi i Ibrahim Kelmendit nga shtëpia e Jusufit është ky:

Pjesë nga "Procesverbal i mbledhjes së Komitetit Vëllezërit Gërvalla i mbajtur më 11/7-1982

Rendi i ditës:

Një analizë e punës së gjertanishme...

Shtatë të pranishmit: Skënderi (Xhafer Durmishi), Halimi (Osman Osmani), Naim Haradinaj, Faridin Tafallari, Haxhi Berisha, Hafiz Gagica dhe Nuhi Sylejmani, njëzëri e aprovojnë propozimin mbi rendin e ditës.

Shpjegim: Në diskutim u vendosë që analiza të bëhet nga 17 janari e gjer më sot.

Faridin Tafallari: ... Sjelljet e Ibrahim Kelmendit (I.K.) nuk kanë qenë të mira.

Naim Haradinaj: Pritjen e quan të mirë megjithëse ram në konflikt me I.K. (Ibrahim Kelmendin). Hapat tonë i quan të drejtë sidomos përjashtimin e tij (I. Kelmendit-shën i Xh. D.) nga shtëpia e Jusufit.

Haxhi Berisha: Ka pasur sabotim dhe zhagjitje të punëve nga ana e I. K. I është tërheq vërejtja disa herë. Sipas mendimit tim ai nuk ka jetuar fare me atmosferën ato ditë.

*Halimi (Osman Osmani): ...Puna ka vazhdua por ka pasur dobësi. Për shkak të mospërvojës mund të kemi bërë gabime, por largimi i tij (I. Kelmendit-shën i Xh. D.) nga familja i mirë për të mos thënë i domosdoshëm. **Gabim strategjik që ia kemi thënë të gjitha.***

Nuhi Sylejmani: Veprime me gjaknxehetësi dhe pa marrëveshje i kanë dhënë I. K. fakte për sulm megjithëse përjashtimi nga shtëpia e Jusufit ka qenë i drejtë.

Skënderi (Xhafer Durmishi): "...Shfaqja publike e dyshimeve ndaj I. K. e gabueshme."

Nga ky dokument, më së interesanti është konstatimi i Osman Osmanit, i cili në shtëpinë e Vëllezërve Gërvalla ka ardhë më 22 shkurt 1982, d.m.th. 17 ditë pas ditës së varrimit më 5 shkurt 1982. Edhe pse ka ardhë pas kaq ditësh ai e gjen I. Kelmendin në Habichthöhe dhe mendon se përjashtimi i tij nga shtëpia e Jusufit ka qenë i domosdoshëm.

Fjalët e tij '**Gabim strategjik që ia kemi thënë të gjitha**' mund të duken të drejta për atë kohë. Në perspektivën historike dhe në bazë të fakteve të mëvonshme, një nga punët më të ndershme e më heroike të asaj kohe që kanë bërë shokët e Jusufit është pikërisht fakti se I. Kelmendi ia kanë thënë të gjitha dhe atë në formë publike dhe në bazë të dyshimeve të bazuara, familja e Jusufit e ka përjashtuar nga shtëpia e vet.

I. Kelmendi: "Potencova këtë rast, nga frika se mos gjatë **bisedimeve, nëse janë zhvilluar aty dhe nga ata që gjendeshin aty, të mos u ketë lëshuar ndonjë shpëtim (më 17 shkurt)**, që të kenë mundësi të thirren "në emër të tyre", pasi edhe gjendja ishte shumë, ta quaj specifike." (Letër Qendrës Ekzekutive, 30 qershor 1983)

13. KOMUNIKATA E BASHKIMIT E BOTUAR NË ZËRI I KOSOVËS, NR.1, QERSHOR 1982

"KOMUNIKATE

*Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mbledhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave **NË NJË TË VETME**. Pas arritjes së bashkimit u vendos që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.*

Në ndërkohë bisedimet u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982.

Me një shkallë të lartë të unitetit të mendimit, përfaqësuesit e tri organizatave në mes tjerash morën këto vendime e qëndrime:

1. Që organizata e re të pagëzohet "Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ).

2. LRSHJ-a si front unik i rezistencës do të përfshijë në gjirin e saj të gjitha forcat patriotike e revolucionare të popullit shqiptar, si dhe të gjithë patriotët në mërgim, të cilët për shkak të dhunës e terrorit serbomadhin janë detyruar t'i lëshojnë trojet e veta të stërlashta.

3. LRSHJ-a do të luftoj për formimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, në të cilën duhet të përfshihen të gjitha territoret etnike shqiptare, dhe për realizimin e këtij qëllimi do të shërbehet me të gjitha mjetet që lejon etika revolucionare, duke u nisur nga bindja politike e gjer tek revolucioni i armatosur, po që se e kërkon nevoja.

4. LRSHJ-a është thellësisht e bindur se duke luftuar për Republikën Shqiptare në kuadrin e Federatës Jugosllave do t'i kontribuoj ruajtjes dhe forcimit të bashkimit dhe vëllazërimit të mirëfilltë në mes popujve të Jugosllavisë. Si përfaqësuese e vetme e popullit shqiptar në shtetin jugosllav, LRSHJ-a konsideron se lufta e saj e drejtë i shërben edhe forcimit të unitetit të Federatës Jugosllave, ruajtjes së paqes në Ballkan dhe stabilitetit të përgjithshëm në Evropë e më gjerë.

5. LRSHJ-a llogaritet në ndihmën dhe përkrahjen e të gjitha forcave progresive të Jugosllavisë, të cilave u propozon luftë të përbashkët kundër forcave hegjemoniste, kolonialiste, shoviniste dhe forcave tjera reaksionare në Jugosllavi, të cilat sot kanë pozita dominuese në të gjitha strukturat e shtetit dhe si të tilla paraqesin rrezik permanent për të ardhmen e Jugosllavisë, për perspektivën e popujve që jetojnë në te dhe për paqen në këtë regjion.

6. LRSHJ-a me të gjitha forcat do të luftoj kundër çdo shovinizmi e separatizmi, sepse edhe këto izma reaksionare, që mund të paraqiten edhe tek ndonjë shqiptar, e dëmtojnë unitetin e Jugosllavisë dhe vetvetiu edhe luftën e drejtë që bënë populli ynë.

7. LRSHJ-a përshëndet qëndrimin e drejtë të të gjithë opinionit progresiv ndërkombëtar, që u solidarizua dhe po solidarizohet me kërkesën e drejtë të popullit tonë për Republikën e vet në kuadrin e Federatës Jugosllave.

8. Përshëndetet qëndrimi i PPSH dhe i qeverisë shqiptare ndaj kërkesës së klasës punëtore dhe popullit shqiptar në Jugosllavi për konstituimin e Republikës së vet në kuadrin e Federatës Jugosllave, me çka dëshmon interesimin e vet për këtë pjesë të kombit dhe principialitetit të politikës së jashtme ndaj RSFJ, ku respektohen me përpikmëri parimet e mosçënimit të sovranitetit dhe integritetit territorial, mospërzierjes në punët e brendshme, respektimit reciprok dhe barazisë së plotë në marrëdhëniet ndërshtetërore dhe ruajtjes së fqinjësisë së mirë, duke qenë gjithmonë në gatishmëri të plotë të mbrojtjes së interesat e pjesë së kombit brenda normave dhe ligjeve ndërkombëtare.

9. LRSHJ-a u bënë thirrje të gjitha grupeve ekzistuese dhe individëve që luftojnë për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi që t'i bashkohen Lëvizjes për Republikë.

10. LRSHJ-a që tash distancohet nga të gjitha format e luftës që mbajnë erë terrorizmi dhe s'do t'ua shtrijë dorën e pajtimit individëve që i kanë duart e zhytura me gjakun e popullit. Gjithashtu Lëvizja s'do të bashkëpunojë asnjëherë me rrymat e organizatat politike që mbajnë vulën e tradhtisë, apo kanë qëllim ta rrezikojnë pavarësinë e Jugosllavisë.

11. Organ qendror i LRSHJ-së do të jetë "Zëri i Kosovës".

12. LRSHJ-a ua bënë me dije si OKB-së ashtu edhe qeverive të të gjitha shteteve që janë për paqe, liri dhe demokraci në botë, se pa iu njohur popullit shqiptar në Jugosllavi statusi i kombit dhe e drejta e patjetërsueshme e tij për Republikën e vetë në kuadrin e Federatës Jugosllave; pa u liruar pa asfarë kushti të gjithë të burgosurit politik dhe pa mundësimin e kthimit në vendlindje të të gjithë atyre që luftuan për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, LRSHJ-a nuk do të qetësohet kurrë.

RROFTE REPUBLIKA SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!

RROFSHIN TE GJITHE POPUJT E RSFJ!

RROFTE LEVIZJA PER REPUBLIKE!

Komiteti Qendror i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në RSFJ" (Zëri i Kosovës, qershor 1982, faqe 2)

14. NACIONALE APO KLASORE

MENDIMI I KVG (Komitetit "Vëllezërit Gërvalla") NË LIDHJE ME LETËRPËRGJIGJEN E KRAHUT TË ISH-PKMLSHJ NË LIDHJE ME PËRGJIGJEN E TYRE NDAJ PIKËPAMJEVE TË SHOKUT LL (Xhafer Shatri)

Xhafer Durmishi: "Letra në të hyrë fillon me komplimente të merituar në adresë të shokut Ll. (Xhafer Shatri- shën i Xh. D.). Lidhur me këto komplimente do të ndalem pak më poshtë.

Çështja jonë me rëndësi, organi është preokupim i hyrjes së përgjigjes. Ajo që thirret teorikisht nga autorët nga të tjerët kjo është realizuar me kohë praktikisht. Këtë e vërtetojnë faktet ashtu siç e vërtetojnë faktet edhe atë se kjo thirrje ka mbetur vetëm në letër nga nënshkruesit e saj. Nga ana tjetër në mbledhjen e fundit të KVG, Halimi (Osman Osmani-shin i Xh. D.) kur ishte pyetja e vendosjes së makinës dhe vazhdimit të punës rreth organit, ai për ta arsyetuar planin e vet rreth shkuarjes në Turqi, para të gjithë

shokëve tha: (duke mu drejtuar mua), organi është preokupim i imi (pra i Xhafer Durmishit-shën im). Sipas marrëveshjes së 15 majit kjo përgjegjësi i ka mbetur Skënderit. Unë kam detyrën të preokupohem për çështjet e LRSHJ-së mbrenda dhe në këtë drejtim i kam filluar punimet.

Unë i kam thënë: Ashtu kemi thënë, por këtë punë e di dikush më mirë se unë edhe se ti, dhe kësaj fjale unë iu kam përmbajt. Për këto fjalë të neve të dyve në atë mbledhje mund të japin deklarata katër vet. Gjatë përgatitjes së numrit të ZK të qershorit unë me Halimin kemi pasur disa mosmarrëveshje. Këto i kam shprehur në dy letra të mëparshme që ua kam dërguar U. (Xhafer Shatrit-shën im), dhe M (Sabri Novosellës-shën im) dhe të tjerëve jo, në mungesë të adresës. Duke u nisë nga këto mosmarrëveshje ai në një rast në zyrat e shokëve gjerman më tha: Në të ardhmen, njëri për organin duhet t'i ketë kompetencat e plota dhe duart e lira. Si variant për këtë e ka marrë veten dhe mua. Në asnjë rast U. (Xhafer Shatrin). Nga kjo rrjedh se fjalët në hyrje të letrës, janë përshtatje sipas realitetit, përshtatje e atillë që në zhargonin popullor njihet dhe shprehet si "kthim kah të frynë era", dhe në bazë të asaj çka kemi vërejtur unë dhe shokët këtu, kjo ishte karakteristika themelore në veprimtarinë politike (s'po guxojmë me thënë patriotike se mund të jemi borgjez të rrezikshëm) të këtyre njerëzve.

KVG e mbron pikëpamjen se LRSHJ-ja është përfaqësuesja e vetme e popullit shqiptar në Jugosllavi. Kjo është shprehur edhe në Komunikatën e botuar në numrin 1 të ZK e e potencuar sidomos në fjalimin e mbajtur në Bern. Deri më tani ne nuk jemi të njoftuar në asnjë reagim kundër këtij mendimi, apo pikëpamje.

"Njëherë e mirë për disa që ende po bredhin në hapësirë"

Shoku KK (Kushtrim Kosova = Abdullah Prapashtica-shën im) si njeri me përgjegjësi, në letrën e tij vëmendje të madhe, gjë që është shumë e natyrshme, i kushton vijës politike duke e përmendur këtë fjali shtatë herë në letrën e tij dhe të bashkëmendimtarëve të vet. Në lidhje me vijën politike që i pëlqen aq shumë ta përmend orë e çast ai tërheq vërejtjen KD (Komitetit Drejtues) të LRSHJ-së se si duhet ndërtuar strategjia e LRSHJ-së: se a duhet të preokupohemi pas nacionales apo klasores por meqë këto janë edhe të pazgjidhshme siç e di edhe vet KK don të na sqaroj se cila duhet të vij në radhë të parë. Për shumicën kjo veç është e qartë, por ai do ta shpjegoj "njëherë e mirë për disa që ende po bredhin në hapësirë..." (faqe 1 e letrës, rreshtat 35-36, vërejtjet dhe citatet tjera me faqe e rresht janë nga kjo letër) se përndryshe sipas tij kjo çështje as që ka nevojë të shtrohet për diskutim. Duhet në radhë të parë të bëjmë luftë klasore arsyeton Kushtrim Kosova sepse:

- po të përmendet nacionalja atëherë bëjmë vetëm luftë klasike (definicion modern),

- duhet të dominoj klasorja sepse kjo është në përputhje me ideologjinë e popullit tonë në pjesën më të madhe të tij.

- duhet të potencohet klasorja në radhë të parë sepse ky vlim më i ri është i frymëzuar nga kjo ideologji (pa i përmendur askund idolet e asaj ideologjie e as ideologjinë në fjalë).

Nuk duhet të vijë në radhë të parë nacionalja sepse:

- armiku nga akuzon për nacionalizëm e irredentizëm.

- se lufta jonë "klasike" patriotike don të thotë shi në misër të rankoviqizmit (faqe 2, rreshti 31).

- se potencimi i nacionales të vë firmën e nacionalizmit (faqe 5, rreshti 6).

- ata që janë përkrahës të kësaj pikëpamje don ta fusin LRSHJ-në në binar borgjez dhe jo vetëm të dyshimtë por edhe shumë të rrezikshëm (f. 5 rreshtat 7,8).

- potencimi i nacionales d.m.th. kthim prapa, në ideologji nacionale (?) dhe kundër internacionalizmit socialist (po ta kishin shfletuar marksizmin apo çfarëdo veprë të kësaj natyre do t'u binte ndërmend se duhet thënë internacionalizmit proletar).

- Sipas kësaj logjike gjërat do të duhet të shikoheshin kështu:

- se një arsimitar në një shkollë fillore së pari duhet të protestoj pse nuk i rritet rroga e pastaj të vijë protestat për atë se: pse nga muret e korridorit të shkollës së tij janë hequr të gjitha fotografitë e rilindasve përveç njërit, nëse emrin e rilindasit apo të heroit e mban shkolla në fjalë.

- se ai së pari duhet protestuar pse nuk i rriten shtesat e fëmijëve para se të interesohet se pse janë censuruar të gjitha vjershat nga librat e leximit dhe abetareve që po atyre fëmijëve ato vjersha ua ndeznin shpirtin flakë me dashuri për atdheun.

- se punëtori në Obiliq apo në Trepçë së pari duhet kërkuar përmirësimin e kushteve të punës para se të kërkoj llogari për grabitjen koloniale të qymyrit, rrymës e mineraleve.

Duhet luftë klasore sepse kjo është në përputhje me ideologjinë e popullit tonë në pjesën më të madhe të tij. Por ajo pjesë e madhe e popullit tonë që sot e ka preokupim ideologjinë, në një kohë siç e ka thënë edhe vet PPSH dhe Akademia e Shkencave e atij shteti, në një kohë para dyzet vitesh PKSH ka bërë vetëm luftë "klasike" nacionalçlirimtare. PKSH në Konferencën e Pezës ka ftuar të gjitha partitë politike (edhe pse parti politike përveç PKSH nuk kishte) në luftë të përbashkët kundër fashizmit. Fitorja e LNÇI në pjesën e stome të atdheut tonë, çoi në fitoren e revolucionit demokratik i cili me punën e vazhdueshme të partisë revolucionit demokratik u shndërrua në një revolucion socialist.

LNÇKVSHJ-ja e ka komprometuar PPSH dhe gjithë shtetin shqiptar

Në lidhje me atë se po nuk u shprehëm së pari për klasoren do të jemi në kundërshtim me ideologjinë dhe me popullin tonë të lirë, sipas mendimit të Kushtrim Kosovës unë po përmendi një fragment të kam pasur me bashkëmendimtarin e KK, Halimin (Osman Osmanin). Ai gjatë një bisede se cila organizatë çka ka punuar e si ka punuar më ka deklaruar: LNÇKVSHJ-ja e ka komprometuar PPSH dhe gjithë shtetin shqiptar duke e shpërndarë literaturën e saj, të ligjësuar këtë veprim edhe me statut, duke e lavdëruar veten se ata nuk kanë pasur nevojë t'i referohen PPSH pasi që e kanë formuar PKMLSHJ e cila është origjinale dhe nuk është në kundërshtim me vetëqeverisjen e Titon por vetëm me rankoviqizmin dhe forcat regresive në LKJ.

Kjo është idioteske, të kapeshe pas disa gjërave pa kurrfarë parimi, por vetëm si ta kërkon rasti për të realizuar qëllimet e tua.

Të flasësh për klasore në cilësinë e një njeriu që do ta trasosh një lëvizje përfaqësuese të një populli dymilionësh në rrugën ml (vërejtje e Skënderit, pasi ml nuk potencohet nga Kushtrim Kosova dhe dy shokët e tij) e të mos i referohesh për asnjë rast qoftë edhe sa për formalitet klasikëve të ml dhe veprave të shokut E. do të thotë se veprat e klasikëve të ml as nuk i ke shfletuar ndonjëherë por vetëm mundohesh të gënjesh të tjerët se je ml e k (marksist-leninist e komunist-shën im).

Veprat e ml asnjë nga ne nuk i kemi studiuar për shkak të kushteve por nga disa shfletime kemi mund me vërejt se ato ku t'i hapësh do të gesh diçka të afërt, të vlershme dhe të aplikueshme në çdo kohë për ty. Ato janë si një lëmsh i madh përçuesish elektrik që për t'ia gjetur fijet të ndihmojnë treguesit e shumtë të veprave të tyre dhe se ku t'i prekësh ato fije, tregojnë rrymë.

Të thërrasësh deri në kupë të qiellit për luftë klasore si në kushtet tona, si në çfarëdo kushtesh, së pari duhet ta kesh studiuar mirë zbulimin e madh të Marksit se: "...

esenca e luftës së klasës nuk qëndron në ndërrimin e një aparati me një tjetër por esenca e luftës së klasës qëndron pikërisht në thyerjen e plotë të këtij aparati dhe zavendësimin e një klase të tërë shtypëse me një klasë shumë më të madhe në masë, me klasën e të shtypurve..."

Të bërtasësh deri në kupë të qiellit e pas shpine të mbash mburojën për vetëqeverisjen e në anën tjetër të thuash se këtë ma mëson Marksi siç po e sheh KK dhe bashkëmendimtarët e tij, nuk shkon.

Nga ana tjetër nga shteti ynë dhe avangarda e tij dhe udhëheqësi i kësaj avangarde është botuar një libër i njohur me rëndësi të madhe teorike e praktike, i cili ia çjerr maskën socializmit vetëqeverisës, që KK me shokë e kanë ndërmend t'ua marrin burokratëve e me ua kthye punëtorëve, tregon esencën e tij kapitaliste. Pra ne konsiderojmë se vetëqeverisja e kapitalizmi për shqiptarët janë një, ashtu siç janë Titoja dhe Rankoviqi një, dhe për këto nuk kemi çka të flasim as për "hir të politikës së madhe" sepse bëhemi për të qeshur edhe nga armiqtë tanë e lere më nga populli ynë. Një dallim në mes Titos dhe Rankoviqit kundrejt shqiptarëve është munduar me çdo kusht ta bëjë LKJ dhe sidomos UDB-a pas Plenumit të Brioneve. Për shqiptarët Tito dhe Rankoviqi janë të lidhur si mishi e kocka, dhe s'ka fuqi që i ndan. Këtë e di më së miri populli i Kosovës që e ka provuar në kurrizin e tij, e di shteti ynë që këto procese i ka parë më mirë edhe se ne, këtë vazhdon ta pohoj çdo ditë edhe shtypi botëror. Dihet sa ka ndryshue e sa s'ka ndryshue gjendja e shqiptarëve pas brioneve. Titoja është ai që e ka shkelë të drejtën e vetëvendosjes, që ka shkelur marrëveshjet e luftës, është ai që ua mohoi më 1968 republikën shqiptarëve që çuditërisht i kishte rënë ndërmend popullit edhe kur nuk ishte aq aktiv në këtë drejtim KK me shokë, dhe që i burgosi e torturoi deri sa i rrahi fryma.

- Duhet luftë klasore në radhë të parë sepse edhe ky vlim është frymëzuar nga kjo ideologji.

Nga është frymëzuar ky vlim në planin më të përgjithshëm dhe shkencor e ka dhënë artikulli i Zëri të Popullit i datës 8 prill 1981. Nga këndi ynë ne mund të flasim më ndryshe dhe të koncentrohemi në atë se pse tha rinia "kështu më nuk durohet". Së pari mendojmë se ky ishte një zgjim i ndjenjës kombëtare deri në atë shkallë sa populli mbarë ta kuptoj se ka ardhur koha e ndryshimeve të mëdha revolucionare. Këtë zgjim para së gjithash e kushtëzoi 100 - Vjetori i Lidhjes "klasike" të Prizrenit, ashtu siç ndikoi më së shumti 500-Vjetori i vdekjes së Skënderbeut në ngjarjet e vitit 1968. Se forcat e organizuara u brumosën me leximin e veprave të shokut E. dhe fituan një ndjenjë shumë të madhe të krenarisë kombëtare nga veprat e I. Kadaresë i cili në Prishtinë u prit si kryetar shteti, ai u dashurua në historinë e tij më të re sidomos nga dy librat e Ajet Haxhiut, të Hasan Prishtinës dhe Shote e Azem Galicës, se e tërë ajo gjeneratë vajzash të shkollave të mesme nuk kishin arritur të studionin veprat e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit e të shokut Enver, por që u frymëzuan aq shumë nga këngët "nacionaliste" të Shyhrete Behlulit e Shkurte Fejzës. Programi i televizionit shqiptar për një vit e gjysmë qe katalizatori më efektiv dhe vendimtar që të shpejtohet një zgjim i tillë në atë shkallë si e kemi sot. ...

Gjatë gjithë kësaj kohe në programin e televizionit shqiptar nuk qe as aludimi më i vogël r. (republikë), për b. (bashkim) me qindra herë. Kur shfaqej drama Shote e A. Galica nëpër Kosovë e sidomos në Drenicë nuk pushonin krismat tërë natën. Kush nuk e di këtë nuk e ka përcjellë televizionin shqiptar. Me një fjalë, nga programet e televizionit shqiptar, sidomos nga emisionet për fëmijë populli i Kosovës e pa se çka do me thënë me qenë i lirë. Kjo ndjenjë e qoi peshë më 1981.

Ai u frymëzua edhe nga shtypi ilegal revolucionar dhe atë nga revistat: Bashkimi, Lajmëtari i lirisë dhe Liria.

Kjo është ajo që e shtyri popullin tonë të thotë mjaft, sipas mendimit tonë.

-Në lidhje me atë se a do t'na etiketojnë si nacionalist armiq të tanë, për luftën tonë, këtë më së miri e ka shpjeguar me shembull mjaft të mirë shoku Ll. duke u shërbyer me proverbin e gjuhës së Krishtit. Pra këtu s'kemi pse me u kthye mbrapa dhe me diskutue rreth saj. Kur Sylejman Vokshit që në fillim i përmendin vdekjen ai u thotë i kënaqur se "përderisa ma përmendni vdekjen kjo do të thotë se ma paskeni pas frikën, dhe të vjetrit tanë na kanë thënë se në luftë kur armiku ta dëshiron vdekjen d.m.th. ia ke arritur qëllimit". (nga drama Epoka para gjyqit).

Armiku po ushtron presion mbi familjet e kuadrove tona

Letra prek edhe një temë të rëndësishme. Udhëzimin për gjakftohtësi ndaj presioneve që po ushtron armiku mbi familjet e kuadrove tona duke e përmendur rastin e familjes së tij (Abdullah Prapashticës-shën im), dhe kjo nuk është hera e parë që me dorë të vet ia nisë me na tregua se si në një letër më parë "... se nga burime të sigurta ka informata se për kokën time (të Abdullah Prapashticës -shën im) është ndarë një shumë e madhe të hollave...".

Tani në këtë letër përmend prapë vetë presionin që po iu bëka në familje. KK dhe shokët e llojit të vet duhet ta dijë se nga ky mes janë përmendur dhe janë bërë presione ndaj disa njerëzve të cilët kurrë nuk i zmadhuan e as si përmendën kurrë me gojën e tyre. Prandaj shoqërisht po u themi lej këto marrina se njerëzit tanë kanë një respekt të madh për ata që luftojnë dhe rrezikohen, prandaj nëse ti s'e ke parë ende këtë të vërtetë, përvishju punës nëse dëshiron ta shohësh ndonjëherë. Me këtë rrugë e me përmendje të vetes nuk do ta sheh askushi.

Sipas kësaj logjike ne jemi "...duke e sulmuar LKJ, me RSFJ me sistem e me Titon e tyre..." (f. 7, rreshti 22) vetëm kur paskan filluar presionet ndaj disa familjeve të disa kuadrove tona. Me këtë fjalor udhëheqësve të lëvizjeve të Kosovës u janë drejtuar qysh prej kohësh Turqia dhe Serbia. Ata e kanë fryrë variantin se udhëheqësit e lëvizjeve të ndryshme çlirimtare të Kosovës janë njerëz shpirtërisht të dëshpëruar apo edhe siç i drejtohet edhe Mexhid beu Sylejman Vokshit në dramën Epoka para gjyqit: "... ç'tu deshtë jeta e malit Sylejman, ti ashtu edhe derfikt nuk ishe...". Pra Turqia dhe Serbia janë munduar që udhëheqësit e lëvizjeve t'i paraqesin si njerëz pa influencë, të dëshpëruar që u ka humbë qetësia personale, prandaj u ka humb arsyja dhe nuk duan të pyesin për të përgjithshmen. Por kjo kurrë s'ka qenë kështu. I tillë nuk ishte H. Prishtina, B. Curri, A. Galica etj. I tillë siç don me na thënë të kuptojmë KK nuk është M. (Mërgimi=Sabri Novosella) i cili ende nuk na e shtroi si çështje se kaq të holla nga burime të sigurta u njoftova se u paguan për kokën time. I tillë nuk është as U. për presionin që bëhet ndaj familjes së tij, me traditë di sot gjithë Kosova, e i cili nuk u kujtua ende të na thotë se shokë shikon çfarë presioni, urra kundër LKJ e Titos së tyre. Me e lavdërue veten na duket punë e ulët edhe nëse thua të vërtetën. S'ke që bënë, kështu kish pas qëllue karakteri i shqiptarit shoku KK (Abdullah Prapashtica).

Ç'ideologji e ç'punë kanë bërë tri organizatat më përpara KVG pajtohet plotësisht me vlerësimet e dhëna në kryeartikullin e numrit 2 të ZK. Këtu po kthehem te fjala opozitë e përmendur në letrën e shokut L.. i ka shërbyer KK jo për të kuptuar të vërtetën se logjikisht kur ne jemi opozitë e LKJ atëherë sipas të gjitha rregullave edhe LKJ është njëherit opozitë e LRSHJ. Fjala opozitë e përmendur në letrën e 10 korrikut i ka shërbyer KK për një frymëzim që t'i hyj një pune që të nxjerr "dokumente me rëndësi" duke hapur në këtë drejtim edhe perspektiva të mëdha për shkencat historike. Sipas kësaj opozitat e LRSHJ qenkan me zanafillë më të re, nga koha e Lidhjes së Prizrenit e pasojat dhe rrjedhimet e saj po e dëmtojnë aktualisht LRSHJ, përfaqësuesit e të cilës janë ca kadro të ish-LNÇKVSHJ dhe OMLK. Se a paraqet Lidhja e Prizrenit fillet opozitare të LRSHJ

e tema të ngjashme ne nuk po mund të hyjmë duke konsideruar se në lidhje me këtë shkenca shqiptare e ka dhënë fjalën e fundit. Në çështje me Lidhjen e Prizrenit, në maj 1978 në Zërin e rinisë ka qenë i paralajmëruar një studim voluminoz i punës 20 vjeçare të prof. dr. Ali Hadrit se do të botohej, por sot e asaj dite se pa dritën me sy. Mos botimi i tij na jep të drejtën të mendojmë se as në atë studim nuk ka ndonjë fjalë se Lidhja e Prizrenit ishte klasike, se paraqet fillet e opozitës së LRSHJ, dhe se aktualisht idolet e kësaj lidhje po të potencohen aq shumë janë shërbyesit më të mirë të rankoviqizmit. E quaj veten të papërgatitur që t'u hyj këtyre temave që aq lehtë i përmend KK dhe i studion me një fjali si me pas qenë baba i Herodotit.

Në lidhje me diskutimet e mëparme rreth çështjes se a duhet të organizohemi në p. (parti) apo në Lëvizje, KK na drejtohej me receta të gatshme: duhet të organizohemi në parti sepse ajo do të jetë parti i e shqiptarëve në Jugosllavi. Pra shumë e qartë, kështu thotë edhe plaku (Bujar Hoxha-shën im). Qëndrimin e tij në Ankara afër plakut (Bujar Hoxhës) KK (Abdullah Prapashtica) ne e ofron ashtu siç ua ofronte Koço Tashkoja grupeve komuniste qëndrimin e tij në Moskë duke thënë se unë jam i pranuar dhe mua më njeh Kominterni.

Të kapesh aq shumë pas ideologjisë e të mos i referohesh asnjëherë asaj do të thotë të jesh një Mao Ce D. i vockël, i cili më 3 shkurt 1967 i kishte deklaruar një delegacioni shqiptar të PPSH: "... për veten time, unë jam një njeri që nuk i dëgjoj radiot, as ato të huajat dhe as ato të Kinës, por vetëm transmetoi." Ai ka pohuar gjithashtu: "Kam deklaruar hapur se nuk do ta lexoj gazetën Zhenminzhibao. Këtë ia thash kryeredaktorit të saj. Unë nuk e lexoj gazetën tënde."

Të kapesh për klasoren me fjalë e në anën tjetër të jesh për ruajtjen e rendit do të thotë të jesh një Mao Ce që kanë nisur me të dalë "gecat". Këtë e vërtetojnë më së miri thirrjet e shpeshta për qeverinë provizore. Maoja ka deklaruar: "... ne dhe Guomindani qankaishist në themel jemi të kundërt me njëri-tjetrin. Si rrjedhim i luftës dhe i përjashtimit reciprok të të dy aspekteve ne me Guomindanin ndërruam vendet..." (Ma Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frengj. f. 479, Pekin 1977).

Faza e tretë

Një komponentë më vete është edhe tërheqja e vërejtjes se dikush po doka me e hedh popullin në luftë "vetëvrasëse" duke e bërë në këtë mënyrë "mish për top."

Që në fillim këta njerëz kanë deklaruar se strategjia e tyre ka qenë të kërkohet republikë me paqe (me telegrame e letra, faza e parë), faza e dytë me dasma masive që edhe ajo u krye. Faza e tyre e tretë thoshin se është revolucion i armatosur. Sipas shpjegimit të Halimit (Osman Osmanit) që të mos jepet as shenja më e vogël jashtë kërkesës për republikë ka qenë se ndoshta ky do të jetë numri i fundit (i Zërit të Kosovës qershor 1982-shën i Xh. D.), se do të kalohet në kërkesën e b. (bashkimit) duke i thënë LKJ se p. (partia jonë) boll të luti e tash ke me pas se çka ka me te gjetë. F., pas Kongresit XII (të LKJ-shën i Xh. D.) tha në një rast në praninë time dhe të Halimit: "Tash s'kemi çka e përmendim republikën, pasi nuk na e dhanë kësaj radhe. Halimi ndërhyri duke i thënë se ke shumë të drejtë. Unë jo njëherë e kam kundërshtuar Halimin se këtu nuk mund të luajmë orë e çast. Më 15 maj (1982) Halimi (Osman Osmani) na ka folë mua dhe U. (Xhafer Shatrit) për ZONËN E LIRË duke na e tërhequr vëmendjen mua dhe U. se çka kemi thënë deri më tash (ne PKMLSHJ-ja-shën i Xh. D.) është bërë si kemi thënë edhe pse thëniet tona nuk janë bazuar në mundësit reale, prandaj është mirë të përpiqemi e të vazhdojmë me atë tempo. Prandaj KK (Abdullah Prapashtica) mos u lodh aq shumë me ua tërhequr vërejtjen të tjerëve për gjëra që ende vet nuk i ke të qarta. Ti me bashkëmendimtarë, me propozimet tuaja je ai që po të kesh mundësi e bënë popullin mish

për top kur thua të lidhemi me b. (Bullgarinë) dhe me udbën e Kosovës e ta shpallim republikën.

Të tëra këto në lidhje me këto sjellje e pikëpamje tregojnë për një pragmatizëm të rrezikshëm që s'ka asnjë fije lidhje me elasticitetin komunist.

Jo KK recetat e gatshme në ideologji nuk hahen. Nëse ke menduar kështu do ta shohësh se ke gabuar. Po më vjen keq që thua të mos bëjmë polemikë, por më duhet të tregoj se polemika në luftën ideologjike është "A". Nëse merr mundimin e me i shfletuar veprat e Marksit, Engelsit e Leninit do të shohësh se 80% e vëllimit të tyre është polemikë. E njëjta është shumë e dëmshme të ndodhë kur kemi të bëjmë me luftë nacionalçlirimtare. Te luftërat nacionalçlirimtare jo vetëm që nuk bëhet polemikë brenda së njëjtës parti por edhe të ndryshmet bëjnë kompromise me njëra tjetrën kundër armikut të kombit. Dhe këto kompromise nuk bëhen duke i fshehur ato me çjerrjen qesharake të unitetit të kristaltë. Pra na u dashtë të bëjmë pak polemikë. Si po e shef, mospajtimet tona nuk janë administrative por qëndrojnë në themel të çështjes. Nuk mund të vepohet me pikëpamje të kundërta në emër të së njëjtës. ...

KVG i përkrah pa asnjë ndryshim më të vogël pikëpamjet e shokut Ll. (Xhafer Shatrit-shën i Xh. D.) të shprehura në letrën e tij të datës 10 korrik 1982.

Komiteti Vëllezërit Gërvalla 1 tetor 1982

Në emrin e tij Shpendi (Xhafer Durmishi)"

(Në emër të Komitetit "Vëllezërit Gërvalla" letra e mësipërme u shkrua nga Xhafer Durmishi)

15. FORMIMI I QENDRËS EKZEKUTIVE NË LUDWIGSBURG

Si është quajtur organi më i lartë i Lëvizjes nga 15 janari 1983 e gjer më 3 mars 1984?

Është quajtur Qendër Ekzekutive dhe ka pasë 5 anëtarë.

Kur është themeluar ky organ, në cilin vend dhe në banesën e kujt?

Është themeluar më 17 janar në banesën e Hafiz Gagicës.

Kur ka ardhur koha e përvjetorit të parë të 17 janarit, është organizuar demonstratë në Shtutgart më 15 janar 1983. Pas demonstratës, jemi tubuar në banesën e Hafiz Gagicës në Ludwigsburg unë, Xhafer Shatri, Hasan Mala dhe Ibrahim Kelmendi. Ka qenë e paraparë me marrë pjesë edhe Faridini, por ai ishte ato ditë në spital. Me propozim të Xhafer Shatrit u vendos që të formohet forumi i quajtur Qendra Ekzekutive, e përbërë prej 5 vetave, pra ne të katërve në mbledhje dhe Faridin Tafallari. Po ashtu **me propozim** të Xhafer Shatrit janë ndarë këto detyra: Xhafer Shatri me gazetën Zëri i Kosovës, Hasan Mala lidhjet me Kosovën, Faridin Tafallari me çështjet financiare, Ibrahim Kelmendi lidhjet me organizatat e huaja dhe unë me çështjet organizative jashtë e sidomos ndërtimi i relacioneve me klubet shqiptare. Kah fundi i këtij tubimi, i cili nuk ka qenë i gjatë, në të cilën është bërë marrëveshja për themelim, andaj edhe nuk ka pasur se për çka të diskutohet aq, me kërkesën e Xhafer Shatrit kemi hyrë vetëm unë dhe Xhafer Shatri në një veturë të një bashkatdhetari për të biseduar pak. Xhaferi më tha se pas ndarjes së këtyre detyrave do të ishte mirë që makina, Stilografi i Jusufit, me të cilën përgatitej Zëri të bartet tek ai në Zvicër, pasi sipas tij (Xh. Sh.) kanë ardhur disa vërejtje të forta e perfide në adresën e Zërit në Biel-Bienne, prapa të cilave mund të qëndroj diplomacia shqiptare. Për këtë arsye duhet ta masim çdo fjalë në peshë të arit, e kjo punë është vështirë të bëhet nëse makina e Jusufit mbetet në Gjermani, por kjo do të ishte shumë më e lehtë të bëhet nëse makina kalon në Zvicër.

Unë, pa u konsultuar me askend tjetër jam pajtue me këtë propozim të atij dhe më është dukur i arsyeshëm. Qysh prej tetorit 1982 pjesa kryesore e shkrimeve të botuara në Zëri kanë qenë edhe ashtu të Xh. Shatrit, e puna ime në thelb më shumë ka qenë teknike se sa ideologjike.

Ka qenë praktikë e asaj kohe që kur formohej një forum, anëtarët e atij forumi të merrnin pseudonime të cilat i dinin vetëm ata anëtarë. Në vazhden e kësaj praktike pseudonimet që janë nda gjatë kësaj mbledhje kanë qenë:

Xhafer Shatri	- Xhema
Ibrahim Kelmendi	- Ilazi
Hasan Mala	-Plaku
Faridin Tafallari	-Fehmiu
Xhafer Durmishi	-Salihu.

Ndokush mundet me thënë se çka na nevojiten me i mbajtur në mend pseudonimet në këtë kohë. Mjaftojnë vetëm emrat (mos qofshin edhe ata të tepërt). Kjo është e drejtë por këto pseudonime janë sqaruese për ata që duan t'i lexojnë letrat që janë këmbyer në mes veti në kuadër të këtij forumi. Pra të gjitha letrat që janë këmbyer në kuadër të këtij forumi janë nënshkruar me pseudonimet e lartpërmendura.

Kjo Qendër Ekzekutive (QE) ka ekzistua prej 15 janarit 1983 (kur është themelua në Ludwigsburg) e deri më 3 mars 1984 (kur është shpërbërë, në një mbledhje të mbajtur në Gjenevë pas demonstratës së organizuar po atë ditë në atë qytet).

16. PA TAKTIZIME

Shoku I. (Ibrahim Kelmendi)

24 prill 1983

..Unë mora vesh nga Xhema kur ishim së bashku atje herën e fundit. ... Morali i dobët dhe patriotizmi mund të bashkudhëtojnë por me bashkjetuar nuk munden dhe ky është një lixh i vërtetuar me mijëra herë dhe që vlen për çdo kend. Pra si për fillim dhe që është hera e parë që po të drejtohem me letër nuk po mund të zgjatem më shumë në këtë drejtim. Po shfrytëzoj nga rasti që të drejtohem për disa probleme si të përgjithshme ashtu edhe konkrete.

Nuk është nevoja që shumë gjëra t'i përsëris apo të shkruaj siç thua ti, fraza rasti. Në bazë të kontakteve dhe vendeve që jemi takuar mund të them se relativisht njihemi mirë. Kemi vendosur me luftuar se bashku dhe këtë do ta bëjmë. Ku kanë qenë punët para një viti dhe ku janë sot e ke ditur e edhe sot e dinë se ku janë qoftë në planin e përgjithshëm qoftë në atë konkret të relacioneve në mes kuadrove. Është mirë edhe me e paramenduar se në çfarë situatë do të ndodhemi pas një ose dy vitesh. Kjo mvaret në masën më të madhe prej nesh.

Ne njihemi vetëm sa na ka kontaktuar puna dhe vetëm puna e asgjë tjetër. Në bazë të saj do të njihemi edhe në të ardhmen. Këto kohët e fundit më ka rënë rasti të vizitoj pothuaj të gjitha rrethet kryesore në RFGJ. ... Opinioneve të ndryshme u intereson lidhja jote me Lëvizjen e mjaft të tjera. Prandaj me aq sa mund të gjykoj është me një rëndësi tejet të madhe studimi i rrethanave sepse sot operacione të ndryshme po zhvillohen shumë shpejt. Në këtë letër po të flas më posht më konkretisht mbi mbresat që kam gjatë takimit ... në rrethin e Dyseldorfit ku isha para disa ditësh, ku në mes të tjerëve ishte edhe vëllau yt... Ti e dinë se çfarë na intereson ne për çdo mjedis dhe nga ky qëllim e zhvillova bisedën sidomos fillimin e saj në Dyseldorf. Tonin ia prishi mjaft Mustafa me pyetje të ndryshme se kjo nuk duhet t'ju interesoj juve, se unë vetëm ia paguaj qiranë klubit, pastaj a e ke pyet Ibrahimin etj. Është mirë me i sugjeruar se kam të drejt të takohem me një rreth në çfarëdo

kohe që duket e nevojshme. F. më patë treguar se ke shkuar atje ku je dhe unë nuk kisha mundësi me të takuar. Është mirë të ndikosh te ai sepse me të tilla pyetje në radhë të parë të dëmton ty. ... Qëllimi kryesor ishte të dija sa më shumë për klubin, pastaj përgatitja e terrenit për koncertin. Ne diskutuam qartë në Gjenevë për statusin e tyre, andaj në atë rreth të ngushtë e shtrova edhe problemin e anëtarësimit me njerëz të rinj e së bashku me këtë problemi të qonte edhe te fotoja e satrapit. Diskutuam në atë rreth të ngushtë prej pesë vetash....

Të fala S. (Salihu=Xhafer Durmishi)

17. ÇDO HAP TJETËR MUND TË KETË PASOJA TË KËQIJA

Të dashur shok të Qendrës Ekzekutive,

4 maj 1983

Kaloj një kohë e gjatë e ngjarje të reja po zhvillohen vazhdimisht, kurse ne nuk po jemi në korrent në mes veti jo vetëm nëpërmes ndonjë takimi po këtë nuk po e bëjmë as në nivelin më minimal përmes letrave. Andaj me anë të kësaj letre u propozoj që pa u vonuar të mendoni për ndonjë datë takimi të mundshëm ku do të shikonim se si jemi duke ecur dhe çfarë është duke ndodhur.

Në takimin e fundit u diskutua edhe përpilimi i Programit Politik të LRSHJ me rastin e njëvjektorit të formimit. Deri më sot, kur jam duke e shkruar këtë letër, për diçka më shumë në këtë drejtim nuk jam i informuar. Poashtu mendoj që përmes letrash të vendoset se kush do ta bëjë një projektprogram i cili në rrethet e ngushta duhet të lëshohet në diskutim së bashku me projektstatutin. Përndryshe çdo hap tjetër në këtë drejtim është joserioz dhe mund të ketë pasoja të këqija.

Pra unë mendoj se koha është që të takohemi mundësisht sa më shpejt. Mendoni në këtë drejtim, programojeni kohën dhe shikojmë se në cilën ditë e në cilin vend mund të takohemi. Kjo shtrohet më problematike për mua dhe Ilazin (Ibrahim Kelmendin-shën. im), por unë për vete jam i gatshëm të vij në Zvicër, ndërsa për herë të tjera si dhe për rendin e takimeve dhe mënyrës së mbajtjes së kontaktit do të vendosim në takim.

Ju përshëndet S. (Xhafer Durmishi)

Shoku Llesh (Xhafer Shatri)

4 maj 1983

Së bashku me letrën e mësipërme po të dërgoj edhe këtë letër që sot ua dërgova dy shokëve tjerë të grupit përgjegjës për Gjermaninë. Lexoje dhe çfarë më propozon tjetër që të bisedoj e si të shkoj puna me ta. Pasi letrat nga Zvicra po vonohen, po që se gjer në takim do të më mungoj fjala jote do të jem i detyruar të flas si ma merr mendja mua e në këtë drejtim janë serioze sidomos problemet rreth temës mbi fraksionizmin në radhët e Lëvizjes. Kjo është e rëndësishme kur të kihet parasysh se tani në Stuttgart që të tretë e firmës së tretë (ish-PKMLSHJ) të cilët përbëjnë kapitullin e veçantë të fraksionizmit në mes fraksionizmave tona. Për arsye të një kontakti të mundshëm me ta, ne duhet t'i informojmë shokët aq sa është e nevojshme sepse këtë e kemi për detyrë. (Xhafer Durmishi)

18. SA MË TEPËR TAKTIZIME ME TË PABESIN GJER NË FUND

Letër e Xhafer Shatrit, 7 qershor 1983.

Anëtarëve të QE

Të dashur shokë, para dy ditësh kam pasur rastin të bisedojë me disa shokë të Dyseldorfit dhe prej tyre jam informuar për shumë gjëra me rëndësi. Çka është kryesore atje Nuhiu me kompani nuk do të mund t'i fusë hundët, e kësaj unë iu kam frikuar jo pak, sepse ata së bashku me statutin e tyre po u çojnë njerëzve edhe letra në të cilat në emër të Komitetit Kryesues kërkojnë prej tyre që t'ia nisin organizimit të celulave dhe krejt kjo në emër të LRSHJ dhe të PK (ML) të Kosovës (Partisë Komuniste Marksiste Leniniste të Kosovës - shën i Xh. D.); Veç po e shpërndajnë edhe fletushkën e tyre me emrin simpatik "Punëtorët". Fletushkën e kam lexuar desha të them statutin, në të ka çdo gjë, por për të mirë pothuaj asgjë, ai ka për qëllim dezinformimin e njerëzve, njoftimin e armikut me format organizative të punës dhe një metodë e paparë e prepotencës (mendjemadhësisë), për këtë çështje ne duhet të ndërmarrim diçka duhet të diskutojmë gjerë e gjatë dhe të ndërmarrim diçka sa më parë që të jetë e mundur, njëherë për njëherë është shpërndarë një takt që është parapërgatitje për demaskim. Natyrisht nëse vazhdon kështu kjo gjendje e nderë, atëherë ata do të mund të bëjnë shumëçka kundër nesh, sidomos në Gjermani nuk është puna hiç mirë... atë ditë ata shokët po më thonë se na ka thënë Musa Daka se ju nuk guxoni të shkoni atje, do të thotë në Gjenevë (sa i përket kësaj ardhjeje ju njoftoj se një natë më ka thirrë baca Zymer, ky s'e ka pasur numrin e telefonit tim dhe po më thotë se a mund të shkojë te ai (ata).

Unë ia tregova punën se nuk kam asnjë mundësi dhe u përpoqa t'ia sqaroj punën e fotos, se ai nuk është ndonjë qëndrim i përgjithshëm për klubet, por shoku ua ka thënë me qëllim që të këqyrni dhe të mos i rrezikojmë shumë njerëz, fliste me tonë të lartë dhe shihej se është shumë i mllefosur.... një natë aty kah ora tre e gjysmë pas mesit të natës, më telefonuan dhe më thanë se po nisemi. Thënë të drejtën nuk arrita të flasë me shumë me ta por u frikova se mos është në pyetje diçka shumë e madhe...) erdhën të nesërmen dhe po më tregojnë se si M. Daka u paska thënë se ju nuk duhet të shkoni pa e pyetur Xhavitin se ai qenka përgjegjës për Gjermani (kuptohet ata e treguan edhe rastin e fotografisë, mirëpo për këtë ne do të bisedojmë më gjerësisht) kjo gjë më brengosi shumë, sepse kjo formë e luftës, nëse kjo mund të quhet luftë është e palejueshme. Lëvizja është një organizatë ilegale që nuk guxon të dekonspirohet para masës, duhet të shihet puna e saj e jo fjalët. Tamam puna sikur ne të dilnim dhe të tregonim përgjegjësit që kemi, kjo metodë është së tepërmi e dëmshme. Lëvizja nuk është një shkop magjik që na i rregullon punët tona as qelës-kallauz që na i hap të gjitha dyert, ne kurrë nuk bënë të flasim në emër të Lëvizjes por me sjelljen tonë, me aftësitë tona duhet ta zbatojmë në masë politikën e Lëvizjes, se flasim në emër të Lëvizjes ne mund t'i themi vetëm shokut të organizuar, dhe një takim me celulën, kuptohet është krejtësisht i ndryshëm me një takim në masën e gjerë. Në këtë drejtim duhet të merren masa të menjëhershme përkatëse dhe të mos përsëriten kurrë më gafe të tilla. Ai i Bremenit ka njoftuar këndeje se Xh (Xhaviti) ka shkuar dhe i ka thënë se unë jam përgjegjës për këtu, sepse punoj me 30 celula, prandaj Zërat e Kos. t'i jap unë. Në anën tjetër shkon një tjetër, ai Faz. (Fazli Memaj) dhe i thotë njeriut se jam kompetent të të pyes pse ti nuk je diçka i kënaqur... edhe një rast tjetër edhe më flagrant me rastin e shfaqjes së koncertit në Dys. shkon Engjëlli (Kolaneci, diplomat shqiptar në Vjenë-shën i Xh. D.) dhe i merr Xh. Hyz dhe Faz. (Xhavit Ramabajën, Hyzri Rekën dhe Fazli Memajn-shën i Xh. D.) e u thotë: ku është Lëvizja, keni kujdes se aty është udha, mos u mashtroni, hapini sytë dhe kështu në këtë kuptim... diçka e

pabesueshme dhe ata burrat e botës asnjëri s'e kanë njohtuar shokun me të cilin kanë kontakt. Çfarë njerëzish mund të jenë ata kur prej tyre ka pasur që kanë thënë në masë se nuk kemi bazë, Lëvizja nuk ka ndonjë bazë të sigurt dhe kështu në këtë kuptim. Shtoja kësaj edhe rastin flagrant të Ilazit atëherë shihet se sa metodë e dëmshme pune është kjo. Sot më shumë se kurrë po bindem se ne duhet të mbështetemi në njerëz të sigurt, sado pak qofshin ata, tre mjaftojnë por ama të jenë burra e shokë.

Me Ilazin (Ibrahim Kelmendin-shën i Xh. D.) mendoj se duhet ta lëmë kështu njëherë të mos i bëjmë zë fare, por ai njeri nuk guxon më kurrë të jetë aty ku e kemi zgjedhur, ai është njeri i papërgjegjësi dhe **gjer në fund i pabesë**. Unë ia kam shkruar një letër në këtë drejtim pa ia potencuar të gjitha këto drejtpërsëdrejti dhe nuk ka kthyer përgjegje, sepse fajtori kurrë nuk ka guxim të flasë, ai mbrohet me heshtjen, që do të thotë se është një pranim faji.

Të tregohen përgjegjësitë që i ka caktuar dikujt populli në një luftë ilegale dhe të dekonspirojë gjëra për të cilat shokët tanë i lënë veshkët e dhëmbët në qeli burgjesh pa qelë gojë, ky është një gjest i papresedan tradhtie e mospërgjegjësie.

Është edhe një rast tjetër, çështja e Shaqës. Në një letër aspak shoqërore Salihu më thotë se e urrej në masën më të madhe unitetin formal, dhe vazhdon pse nuk po ndalen thashethemet kundër Shaqës (Shaqir Shabanit-shën i Xh. D.). Dreqi e marrtë po Shaqa i ka nxitur vetë thashethemet me sjelljet e tij të poshtira udbeske, ai shkon dhe i thotë njeriut shko dhe organizoje filan fistekun në Lëvizje sikur L. të ishte kafene pastaj i mashtron dhe i frikëson se do t'ua qesë në Zërin e Kosovës, se ka kompetenca të mëdha e çka po di unë. Për këtë njeri unë nuk dua të harxhoj fjalë e kohë, por po them se ky është një element destruktiv puna e të cilit nuk ka asgjë të përbashkët me Lëvizjen. Ai ose është ambicioz i sëmurë, ose njeri i udbës, dhe unë më shumë droj se ky është i dyti. Tash po na dalin fakte se ai po u thotë shokëve në Gjermani që të kenë kontakt vetëm me Nuhiun... Pra puna ka shkuar larg. Ai njeri kurrë s'i ka shkëputur lidhjet me ish-padronin e vet....

Kohët e fundit kam qenë shumë i zënë, kam pasur shumë kontakte me shokë të brendshëm dhe besoj se ia kemi arritur të bëjmë shumëçka: atje do të shpërndahen trakte e do të kryhen aksione vetëm nga ana e LRSJH dhe do t'ia arrijmë që veprimet e fëlliqura të këtyre fraksionistëve të evitojmë në një masë të madhe... por kjo do shumë punë, tmerrësisht shumë punë dhe nerva, prandaj do të ishte mirë që me organizimin jashtë të merreni të gjithë më shumë dhe sidomos Salihu që e ka përgjegjësi kryesore. Ai duhet t'i krijojë kuadrot tona të ardhshme dhe të gjithë frenjtë e organizimit t'i përqëndrojë në duart të veta, por kuptohet me një punë dhe përgjegjësi në nivel me obligimin që ka. Në bisedë telefonike me të mbrëmë po më thotë s'kam të holla... ky nuk është një arsytim bindës, fundja të hollat për kënd i kemi, për luftën e jo për sytë e zi. Sidomos në këtë kohë ai është dashur të jetë në mesin e punëtorëve në St. (Stuttgart) dhe ta rrokim punën përpara, sepse kemi të bëjmë me njerëz që s'kanë fije burrërie, por që do të merren edhe me denoncime te armiku, për këtë jam i sigurt, por nëse ne punojmë, nëse ne e qesim shpesh dhe kualitativ ZK ata nuk kanë çka të bëjnë. Do të ishte mirë që në këtë drejtim t'i përqëndrojmë të gjitha forcat tona dhe ta lëmë në heshtje punën e tyre, kuptohet duke e qitur krejtësisht nën hije punën e tyre përçarëse e minuese, pra me punë.

Pastaj lidhur me ta t'i sqarojmë punëtorët sa më tepër jo vetëm gojarisht dhe duke e përqëndruar vëmendjen në qëllimet e tyre tamam armiqësore, e jo duke ndenjur nën hije, sepse ara pa i zhytur këmbët në dhe nuk mihet... Ka kuadro bile shumë, por ne nuk po punojmë sa duhet, po na mungojnë ata militantët që s'u shihen kurrë gjurmët por që u ushton puna, e Halimi duhet ta dini është talent i intrigave dhe mashtrimit të njerëzve, prandaj Salihu duhet ta ketë parasysh këtë dhe ta formulojë një formë të veçantë për t'iu kundërvënë. Në këtë drejtim të mendojmë edhe ne si t'ia bëjmë. Natyrisht pa një unitet mendimi e veprimi nuk do të kemi sukses. Mua s'më pëlqen ajo që para syve të luajmë

rolin e unitetit e pastaj kur të ftohet muhabeti të ndërrohet pllaka. Vetë nga toni i bisedës së Salihut mbrëmë unë kam kuptuar shumëçka. Edhe pse nuk jam ithtar i mbledhjeve të shpeshta, kjo më detyron të insistoj për një takim të ngutshëm. Ne i kemi marrë detyrat, prandaj çdonjëri prej nesh le të shkrihet për realizimin e tyre, le të duket puna. Natyrisht takimet janë të frytshme dhe mëse të domosdoshme, por po e shihni edhe vet se në çfarë kushtesh po veprojmë, pa dokumente, pa mjete materiale të bollshme, pa status të sigurt, si në vend të huaj më.

Vendin e Ilazit (Ibrahim Kelmendit-shën i Xh. D.) mendoj se duhet ta plotësojmë, por pa e njohtuar njëherë përnjëherë, **me të duhet të taktizojmë sa më tepër që të jetë e mundur....**

Ju lutem të mendoni për këto dhe të vendosni diçka menjëherë. Për shkak të largësisë unë dhe plaku mund të dalim deri kah Baseli, në mënyrë që ta ndajmë përgjysmë rrugën e besa edhe shpenzimet.

7 qershor 1983

Xhema (Xhafer Shatri)

19. DISKUTO ME ATA TEK TË CILËT KE NDËRMEND TË MBËSHTETESH MË SHUMË

Shoku Ll. (Xhafer Shatri)

13 qershor 1983

... Lidhur me fraksionistët mendoj që përgjigja duhet t'u bëhet por jo në ZK sepse në këtë mënyrë mund t'u bëjmë shërbim, dhe kësaj t'i japim përmasa sepse aty ku shkon ZK, këtyre do t'u nevojiten vite të tana me mbërri, gjë që s'do të mbërrijnë kurrë. Kështu që përgjigja të dërgohet tani për tani vetëm në ato vende ku mbërrijnë ata. Në këtë drejtim unë kam menduar me e përgatitë një libër të tërë skeletin e të cilit e kam bërë dhe do ta dërgoj e nëse të duket i arsyeshëm e thellojmë punën në atë drejtim. Kjo s'do të thotë që mos me ua bërë edhe një përgjigje në një trakt dy faqesh, kurse në libër mendoj të jenë të rrahura shumë probleme më gjerë, dhe me llojet e tjera të fraksionizmit. Unë jam i kënaqur me atë skelet.

Lidhur me takimin rregullojeni si ta gjeni më të përshtatshme. Unë në të ardhmen sigurisht nuk do të mund ta bëjë atë që së paku është thënë teorikisht ta bëjë. Andaj se çfarë taktike do të përdoret dhe si është më mirë të zhvillohet lufta **diskutoje me shumë me ata që e ke ndërmend të mbështetesh më shumë**. Unë do ta bëjë edhe në të ardhmen atë që më thuhet por jo, me hy deri në atë shkallë sa me i ngritë punëtorët grushtet kundër njëri-tjetrit siç ka ndodhë me vëllaun e Ilazit dhe Musa Dakën.

Të fala S. (Xhafer Durmishi)

20. QARKORE INTERNE LIDHUR ME RASTIN E ISH-PKMLSHJ

Qarkore e shkruar nga Xhafer Shatri në emër të Redaksisë së Zërit të Kosovës, qershor 1983

- Kohët e fundit ka nisur të shpërndahet nëpër Gjermani një broshurë me titull: Platforma Politike, Programi dhe Statuti i OS (organizatës sindikale) Bashkimi i Punëtorëve të Kosovës. Në këto 40 e sa faqe ka gjithçka, prandaj kësaj radhe s'po e analizojmë fare përmbajtjen e saj, le ta bëjë këtë vet lexuesi, por po e analizojmë atë çka i parapriu kësaj: Në vitin 1981 në Kosovë për herë nisi të flitet për PKMLSHJ (Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi), ajo nisi ta nxjerrë organin

e vet në dhjetëra kopje me titull "Revolucioni", njëherë tjetër Zërin e Atdheut, kjo e fundit është shpërndarë shumë pak, kështu që nuk dihet për të, ndërsa "Revolucioni" është më i njohur nga ajo se te lexuesi i pjekur që ka qenë në dijeni të organizimit ilegal në Kosovë, ka lënë përshtypje me prepotencën e pashembullt të njerit prej numrave të tij, në të cilin autorët e tij pohojnë se gjoja ata qenkan ata që i kanë organizuar demonstratat e 81, dhe se për këtë sukses kryetari dhe sekretari gjeneral e kanë shpallur veten heronj të popullit. Këto gjëra i kanë indinjuar së tepërmi sidomos njerëzit që kanë vepruar në ilegalitet të thellë gati me dekada, por kurrë s'kanë nxjerrë zë, ata e kanë lënë të tregoj puna e tyre; kjo që thamë, niveli i ulët intelektual i shkrimeve të tyre, fjalori i konferencave jugosllave bënë që te shumë njerëz të fitohet përshtypja se kjo është vepër e UDB-së, në të vërtetë autori i shkrimeve ka punuar në SPB. Këtë organizatë në një masë e ka popullarizuar edhe regjimi duke shkruar për të në kohën kur ata kërkonin me pishë njëri për t'ia hedhur fajin për Pranverën e 81, sepse ishte qëndrim i organizata tjera ilegale që një shpërthim i tillë në opinion të paraqitet si vepër spontane e popullit pavarësisht nga ajo se kush ka kontribuar në atë drejtim, sepse kjo do të ishte shumë më akuzuese për armikun. Veç kësaj kjo org. në fjalë e ka përdorë me sukses luftën psikologjike, të gjitha shkrimet e veta së pari ua ka dërgua organeve krahinore, kuptohet duke i ngjitur vetes emra të mëdhenj e fjalë që me asnjë rast s'i ka përcjellë punë përkatëse. Kjo metodë është treguar e suksesshme sepse e ka popullarizuar këtë organ. Në të vërtetë kjo organizatë ka qenë, sikundër që edhe është vepër e një grupi të ngushtë familjar dajë, nip, dajë etj. Për herë të parë në Kosovë këta kanë lëshuar në "përdorim" një formë të vjetruar organizative, të kohës së Leninit apo të tipit të sotëm të Perëndimit, do të thotë celulat dhjetëshe, gjë që për realitetin kosovar kjo është treguar si shumë e pasuksesshme, madje edhe e rrezikshme. Në këtë formë organizimi nuk ka pasur asfarë seleksionimi të njerëzve dhe të përfitimi i simpatisë së tyre, siç po mësojmë kohët e fundit, është përdorë me të madhe shantazhi në këtë stil: je i rrezikuar prej policisë, unë punoj në UDBë, ndaj e di mirë, pra eja të të strehojmë, dhe njëmend i kanë strehuar njerëzit viktimë e kësaj forme pune janë profesorët që u dënuan në procesin e fundit politik në Prishtinë. Ata, pa qenë fare, janë dënuar si njerëz të organizuar.

Një parantezë. Në prag të vrasjes tragjike të shokëve tanë Jusufit e Bardhoshit (kanë qenë siç dihet anëtarë të ish Lëvizjes nacionalçlirimtare...) dhe Zeqës (anëtar i ish-Organizatës Marksiste-Leniniste...) janë zhvilluar bisedime për bashkim. Bisedimet kanë qenë të suksesshme dhe sipas të gjitha gjasave natën e vrasjes ka ardhur gjer te bashkimi. Këto organizata kanë vepruar në mërgim sidomos dhe gjithmonë i kanë koordinuar aksionet, janë ndihmuar në mes veti me të madhe, ky është një fakt i padiskutueshëm. Pas rënies së tyre në popull u krijua një indinjim i pakufishëm e mjerisht edhe një huti e palejueshme... Në Kosovë u bënë burgosje të mëdha. Nga të gjitha organizatat u burgosën shumë njerëz, shumë të tjerëve iu deshtë t'ia mësyjnë mërgimit, ndër ta edhe udhëheqësi i PKMLSHJ. Në mërgim janë zhvilluar bisedime në mes tij dhe shokëve të ish LNÇ... ka ardhur te bashkimi, gjegjësisht formimi i LRSHJ, jo LRSSHJ. Përkundër kësaj nuk është zhvilluar kurrfarë aktiviteti, kjo ka mbetur anonime, çështje e tre-katër njerëzve. Në maj, më 14 e 15 maj janë zhvilluar bisedime edhe me përfaqësues të ish OMLK. Ka ardhur gjer tek bashkimi gjegjësisht formimi i LRSHJ. Për këtë ekzistojnë dokumente. Në bisedime kanë qenë dy përfaqësues të organizatave të mëparshme, si përfaqësues të organizatave të tyre.

Kur ka ardhur te botimi i komunikatës, përfaqësuesi i ish-OMLK-së ka insistuar që ajo të përpunohet pak, por në esencë të mbetet e njëjta, dhe i ka bërë ndonjë plotësim, ashtu siç qe vendosur, dhe e ka dërguar në botim, mirëpo përfaqësuesi i ish-PK... ka insistuar në që në komunikatë të futet pasusi se prijëse ideore e Lëvizjes do të jetë Partia Komuniste, gjë që në fillim tingëllonte fare padjallëzisht... Njeriu kur të bashkohet me

dikend të luftoj për të njëjtin qëllim aty s'ka asnjë vend dyshimi, dhe thënë të drejtën sikur të mos ishte përfaqësuesi i LN... kjo do të bëhej, mirëpo ai duke i njohur mirë ua hetoi qëllimin, dhe kuptohet doli komunikata që thotë se LRSH është një organizatë unike e operative... U zgjodhën organet e përkohshme udhëheqëse, por në mbledhjet e tyre mungonte përf. i PK... ai insistonte rregullisht që të flasim vetëm në katër sy... Fillimi si çdo fillim nuk na mundësonte takime të shpeshta nisëm të letërkëmbejmë. Shoku i PK nuk përgjigjej në letra, më vonë njëri prej tyre shtroi në një letër të gjatë propozime të shumta që dukeshin të papranueshme, ndër të tjera insistonte të formohen organizata të brendshme si Fronti demokratik, organizata e gruas, e pionierëve etj. gjë që për realitetin kosovar kjo është e pamundur: në një shtet totalitar të tipit më fashist t'i shkapërderdhësh njerëzit kjo është vetëvrasje. Në të tjera kushte ka vepruar PKSH, ajo e ka pasur malin... ndërsa Kosovë është krejt diçka tjetër. Në këto shkresa kemi dhënë përgjegje të qarta dhe kemi shprehur mendimet tona. Kemi insistuar për një takim, sepse e pamë se veç ia kanë nisur t'i përçajnë radhët tona, të organizojnë edhe njerëzit e organizuar, duke u shërbyer me shpifje dhe dinakëri krijuan konfuzion të madh sidomos në rrethin e Shtutgardit. Kjo reflektohej keq te punëtorët. U përpoqëm të bisedojmë bashkarisht për këto probleme, por u iknin takimeve. Njëherë udhëtuam me mija kilometra për t'u takuar, por ai burri i botës i iku takimit, vetë shoku i tij më i ngushtë ikjen e tij e çmoj si tradhti... Ky rast pati pasojë të mëdha. Herën e dytë i shkruam letër urgjente që të propozojnë se ku po shihemi dhe kur, bile morëm përsipër që të udhëtojmë 5000 kilometra, me rreziqe të shumta, por përgjegje morëm vetëm pas dy muajsh, kuptohet përgjegje negative. Shkruanin herë pas herë, nuk kthenin përgjegje, apo më mirë, shërbeheshin me arsyetime që s'ishin gjë tjetër veçse gënjeshtër fare të paskrupullta. Duke e parë se çdo gjë është e kotë edhe ne e ndërpremë letërkëmbimin aty kah viti i ri duke thënë se kur të bëhen gati le të shkruajnë në ZK e ne do t'u japim përgjegje. Atë ditë e sot nuk kemi marrë letër. Gjersa marrëdhëniet nuk ishin aq të ftohura ata e shpërndanë një trakt disafaqesh me konglomerat idesh, por në të kishte edhe gjëra të mira. Për shpërndarjen e këtij trakti kemi marrë vesh pasi që na ka ra në dorë. Disa herë kanë premtuar se do të shkruajnë për ZK, këtë e kanë bërë shumë rrallë dhe punimet kanë qenë krejtësisht të dobëta, fare të papërpunuara. Kanë premtuar se do të dërgojnë informata për një dëshmor të ri, Afrim Abazin këtë s'e kanë bërë kurrë. Në një letër të mëparshme kur autorit të këtyre rreshtave i propozuan ta bëjnë "kryetar" të L. dhe kur ky propozim u injorua, si duket i humbën të gjitha shpresat se do të mund të luajnë me emrin e Lëvizjes, të cilës, duhet të themi, duke keqpërdorë sinqeritetin tonë ia imputuan emrin me ndajshkrimin LR(S)SHJ, sepse në dokumentet e bashkimit përmendet vetëm LRSHJ, asgjë tjetër. Këtu është shkaku pse edhe sot e tutje në ZK përdoret vetëm në një vend LRSSHJ (Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në J.). Në këtë letër-informuese është vështirë që për një kohë fare të shkurtë të përfshihen të gjitha ato që na shtynë të bashkohemi, pastaj ato marrëdhëniet **ngreh e mos e këput** që për ne kanë qenë torturë, minimi i radhëve nga brenda, intrigat e ndryshme, mossinqeriteti total, dëshira e sëmurë për dominim etj. kanë qenë arsenal i tyre i përditshëm në marrëdhënie me ne. Për hir të unitetit ne jemi treguar së tepërmi tolerantë, apo për të thënë më mirë oportunistë. Me ta është dashur ta shkëpusim që në fillim. Me njerëzit që nga hija e vet nuk e shohin interesin e luftës e të popullit, ne s'na lidhë asgjë. Kjo broshurë më tepër është një konglomerat budallëqesh se sharlatanrie të pashoqe. Autorët (i) i saj nuk e njeh apo thënë më mirë se njeh fare realitetin e sotëm, apo thënë ndoshta nuk do ta njohë. Nisur nga kjo që në biseda verbale dhe në mbledhje të ndryshme duhet të plotësohet edhe me shembuj më të freskët e më të imët, tash për tash shtrohet si detyrë që të gjithë anëtarët e LRSHJ ta analizojnë këtë broshurë dhe të shprehin mendimin për të, pa kurrfarë mërie ose inati personal. Ne qëllimisht s'po e bëjmë këtë, sepse na nevojitet mendimi i të gjithë shokëve e pastaj nga ato do të marrim një vendim.

Një gjë është e qartë: ky është një fraksion që mund ta dëmtojë, por kurrë ta ndalë hovin e Lëvizjes. Këta janë njerëz që nuk kanë ndikim në masë, ata i frikohen takimit me të, nuk kanë kurrfarë aftësie intelektuale për të shkruar diçka të mirë, apo aftësi organizative që ta dëmtojnë armikun ashtu siç e kërkon populli sot dhe kushtet ekzistuese. Është dëshmuar se janë mendjemëdhën timer të sëmurë, njerëz në të cilët nuk mund të mbështetemi kurrë, dhe s'mund të shohim asgjë të mirë. Sikur të ishin shokë, ata kanë mundur të kontribuojnë, sepse udhëheqësi i tyre ka punuar në çerdhen e armikut dhe ka mundur të na informoj e mësoj për shumë gjëra. Ka ndodhur krejtësisht e kundërta. Mjerisht puna ka shkuar edhe më larg, ka fakte se po na i denoncojnë njerëzit e tyre shokët tanë më të mirë. Sidomos kjo po na dëmton shumë. Është edhe një e keqe tjetër: ekziston dyshimi i themelshëm se në mesin e njerëzve të tyre ka edhe njerëz që punojnë për armikun, fundja të gjitha veprimet e tyre çojnë ujë atje... ku s'duhet. Por megjithatë ne nuk guxojmë të jemi shpirtngushtë dhe t'i kualifikojmë si armiqë e tradhtarë, pavarësisht se puna e tyre është kokë e këmbë e tillë.

Lidhur me këtë nga shokët tanë kërkohet që gjithsesi ta studiojnë këtë broshurë dhe sa më parë t'i shprehin mendimet e veta. Gjatë leximit ta analizojnë së bashku çdo rresht dhe të vinë vetë në përfundime të drejta. Duam ta dimë poashtu se a mendojnë shokët t'i demaskojmë apo jo, t'i luftojmë haptas dhe ta bindim popullin se kush janë e çka duan apo ta lëmë për një kohë se si po zhvillohet situata. Por një gjë duhet ta kemi parasysh, këta njerëz mbjellin hutime e dezorientim te masat dhe kjo është shumë e dëmshme, sepse komprometohet emri i Lëvizjes, e ata do të vazhdojnë të veprojnë edhe në të ardhmen në emrin e saj, sepse ky është paravani më i mirë përmes të cilit ata i fshehin budallallëqet e veta. Ky është i vetmi shkak që na shtynë të merremi me ta, përndryshe ata janë fare të parëndësishëm. Do të mund të ishin të rrezikshëm vetëm nëse lidhen me ndonjë shërbim të huaj informativ, sidomos me atë bullgar, siç ka propozuar shefi i tyre njëherë, por e kemi kundërshtuar, mu për këtë duhet të jemi shumë e shumë vigjilentë, t'i sqarojmë masat, sepse ata kanë për qëllim të fusin konfuzion dhe në emër të saj të verbojnë Lëvizjen. Të aktivizohemi të gjithë në zbulimin e njerëzve që e shpërndajnë këtë manifest të budallallëkut dhe t'i sqarojmë punëtorët, por pa hyrë në detaje të marrëdhënieve tona me ta. Ata duhet t'i luftojmë me punë të përditshme dhe jo me thashetheme.

Presim mendim të menjëhershëm

Redaksia e Zërit të Kosovës (Qarkore nga Xhafer Shatri, qershor 1983)

21. KËRKESA IME (XHAFER DURMISHIT) PËR DORËHEQJE NGA QENDRA EKZEKUTIVE MË 10 KORRIK 1983

Pas 12 marsit 1983 e udhëtimeve të mia që i bëra me ndihmën e shokëve të Shtutgartit në München, Düsseldorf, Bielefeld e Hamburg në muajt prill - qershor 1983, unë vendosa me dhënë dorëheqje nga Qendra Ekzekutive. Shkaqet për këtë ishin këto: Unë nuk mund të kryeja atë detyrë që më ishte dhënë (marrjen me çështjet organizative jashtë) pasi me këtë punë merreshin tërë kohën vetë Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi. Ibrahim Kelmendi e trajtonte klubin "Emin Duraku" në Düsseldorf pronë shumë më private se sa hisen e tokës që mund t'ia ketë lënë baba i vetë apo ndonjë bakshish të dajës

Ramë. Xhafer Shatri zhvillonte një korrespondencë të dendur edhe për çështje organizative me rrethe të ndryshme e me shokë që kisha kontakte personale në Shtutgart dhe kurrë nuk më njoftonte për ndonjë instruksion të tijin. Ai i kishte fshehë letrat e drejtuara për mua, që më kishin ardhë në adresën e Zërit të Kosovës në Biel/Bienne, për mos me m'i tregua me arsyetimin se "jeta e ka mësue mos me i besua askujt." Kur letrat e mia nuk m'i ka përcjellë, kërkesa për të më treguar ndonjë komunikim me të tjerët më duket se del sa absurde aq edhe qesharake. Xh. Shatri më thoshte se duhet t'ju afroresh punëve ngadalë e t'ua rrëmihësh dheun të tjerëve nën këmbë. Kjo farë kopilie e rrëmihjes së dheut nën këmbë e kjo farë taktike nuk më interesonte dhe nuk më hynte në punë për ndërtimin e sa më shumë klubeve dhe bashkimit të bashkatdhetarëve në këto klube. Mua, shokë në Düsseldorf në verë të vitit 1983 më treguan se na ka thënë Bacaloku (Xh. Shatri), kur të vjen Skenderi i Shtutgartit (Xhafer Durmishi), ndiqeni me rrametë.

Aspekt tjetër ishte letra e tij e 7 qershorit 1983. Nga ajo që kisha dëgjuar për Xhafer Shatrin në Kosovë, dhe nën influencën e Sabriut, unë kisha pasur një respekt e nderim më të madh se sa ai e meritonte. Fillimisht qëndrimi im (përkundër keqkuptimeve fillestare të cilat i konsideroja të rastit) ndaj tij ishte pikërisht ai që kisha pasur ndaj Jusufit. Ai gjykoi dhe na vendosi në një forum së bashku me Ibrahim Kelmendin. Për këtë ai shpejt u pendua por kishte frikë me u ballafaqu me të vërtetën dhe mirrej me taktizime të dobëta e pa asnjë princip, duke i vendosur në pozitë shumë të keqe pranuesit e letrave të tij (sidomos të asaj të 7 qershorit 1983).

Për këto shkaqe unë pata vendosë me kërkua dorëheqje në mënyrë të qetë që të shkëputem prej Xhafer Shatrit, Ibrahim Kelmendit dhe kleçkave të tyre. Xh. Shatri e kishte trashëguar një situatë delikate prej Kadri Zekës dhe rrethit të tij. Ata për të gjallë të Jusufit nuk kishin pranuar me e marrë e të mos flasim për shpërndarjen e Zërit të Kosovës. Tortura e tyre shpirtërore pas mbetjes së Zërit të Kosovës, Zërit të Jusufit si e vetmja gazetë, mundet vetëm me u marrë me mend. Në njëfarë mënyre unë i kuptoja kleçkat e kurthat e Xh. Shatrit si një lloj kompensimi me të cilin ai kishte nevojë me i ushqye shokët e vetë. Figura ime ishte tepër e lidhur me Zërin e Kosovës, andaj urrejtjen që e kishin pasur kundër kësaj gazete e kishin fokusuar në personin tim. Unë përpiqesha të kem mirëkuptim për vuajtjet e traumat e tyre dhe pata vendosur të jap dorëheqje. Me sakrifikimin e vetvetes mendoja se do ta forcoj pozitën e shokëve të Shtutgartit, pasi mendoja se urrejtja e tyre e madhe kundër meje nuk do të shkarkohej mbi ta. Pastaj mund të thuhet se në ato ditë edhe Xhafer Shatri edhe unë kishim të drejtë me qenë shumë të kënaqur: ai për arsye se brenda një viti, me mjeshtërinë dhe përvojën kolosale, kishte arritur të ngritet në krye të Lëvizjes, duke pasur maqinën e Jusufit, një adresë gazete në të cilin i vinin letra dhe një xhirollogari në të cilët bashkatdhetarët dërgonin ndihma. Unë në anën time, edhe pse niveli i ambicieve kishte qenë jashtëzakonisht më i vogël, përkundër aftësive të kufizuara dhe mospërvojës kisha dhënë kontribut vendimtarë për të ruajtur emrat "Lëvizje" nga Lëvizja e Jusufit, dhe "Zëri i Kosovës" nga Zëri i Jusufit. Unë nuk kisha ndonjë shpresë tjetër se jeta ka në fshehtësi detyra më të rëndësishme për mua.

Në bazë të poshtërsive që ishin bërë në drejtim timin unë kërkova dorëheqje nga një Qendër e tillë. Megjithatë unë isha i interesuar që puna t'i shkoj mbarë kësaj Qendre Ekzekutive edhe pa mua, sa edhe u propozova që vendin tim mund ta zenë Xhavit Ramabaja, aktivist në Bielefeld, Gjermani. Kërkesa ime për dorëheqje nuk u aprovua prej asnjërit. **Unë e tërhoqa këtë kërkesë sidomos për hir të Faridin Tafallarit dhe Hasan Malës, duke gabuar kështu,** pasi sikur të kisha qenë këmbëngulës në këtë pikë do ta kurseja veten nga ekspozimi prej shumë konflikteve artificiale e disa punëve të ulëta.

22. STATUT I LEVIZJES PER REPUBLIKEN SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI (LRSSHJ)

Xhafer Durmishi: "Sa i përket Statutit të përgatitur nga ana ime kam këto vërejtje; duhet shtuar definimin e saktë se kush është, mund të quhet anëtarë i Lëvizjes, dhe një nen të ri që ka të bëjë me sjelljet e anëtarëve të Lëvizjes që veprojnë në shtetet e ndryshme, të cilët nuk guxojnë të bien në kundërshtim me ligjet e vendeve në të cilat veprojnë. Pastaj vërejtjen tjetër, në kapitullin e parë që ka të bëjë me datën e formimit të LRSHJ. Më 10 korrik 1983, Uka më tha se do të ishte shumë mirë në Komunikatë ta kishim shënuar vetëm 15 majin, pasi fraksionistët e PKMLSHJ nuk do të mund të qëndronin shumë, pasi kryesisht ata po thirren në 17 shkurtin. Duke u nisur vetëm nga ai qëllim dhe sidomos kur ka qenë në pyetje fraksioni që u shërbye me metoda shumë të ulëta mua më është dukur e arsyeshme dhe ky ka qenë shkaku kryesor që unë në atë statut e kam shënuar datën e 15 majit. Tani Mërgimi thirret në të njejtën mënyrë si Uka se qëllimi të shënohet 15 maji ka për qëllim ta devijoj vijën për Republikë për të cilën kemi vendosur më 17 shkurt. Unë nuk ju kam kushtuar vëmendje të duhur këtyre gjërave, sepse për natyrën time nuk më janë dukur gjëra të dorës së parë. Pasi çështja është shkruar kështu, atëherë pavarësisht se si do të shprehem as 17 shkurti nuk mund të fshihet pasi është një fakt, kur janë bërë bisedime dhe është vendosur, çka është më kryesorja, emri i organizatës të cilës më 15 maj nuk iu ndryshua asnjë pikë dhe asnjë presje. Sido që të jetë unë nuk jam për atë që të bëhet objekt diskutimi kjo çështje. Faktet historike mbeten fakte, unë jam për atë që me ato të merret historia." (Letër Qendrës Ekzekutive, 3 janar 1984)

I

Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi është përfaqësuesja e interesave të vërteta të popullit shqiptar në Jugosllavi. Aktualisht ajo është luftëtarja më e denjë për realizimin e këtyre interesave.

Lëvizja është një bashkim luftarak vullnetar patriotësh e revolucionarësh të popullit shqiptarë që jeton në Jugosllavi dhe i asaj pjese të tij që fati historik e detyroi të mërgoi nëpër shtete të ndryshme të botës, të cilët përpara interesit të përgjithshëm i kanë sakrifikuar të gjitha interesat tjera.

LRSSHJ u ngrit mbi bazën e organizatave LNÇKVSHJ, OMLK, FKP dhe PKMLSHJ.

"Zëri i Kosovës" është vazhdim i denjë, i përshtatur, për atë që kanë lejuar të gjitha rrethanat që të përshtatet, i "Bashkimit", "Lajmëtarit të lirisë", "Lirisë" dhe i ndonjë botimi tjetër që nuk ka çuar shumë peshë në jetën politike të popullit shqiptar në Jugosllavi.

Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, të tillë siç e njohin sot të gjithë shqiptarët, u themelua më 15 maj 1982, nga revolucionarët kosovarë, mbi bazën e lëvizjes patriotiko-revolucionare të organizatave patriotike.

Qëllim i Lëvizjes është që të grumbulloj atë forca rreth vetes, sa me atë forcë të grumbulluar t'i bëjë presion udhëheqjes federative, dhe me këtë t'i imponoj kësaj të fundit një situatë të atillë në të cilën ajo do të detyrohet që popullit shqiptarë në Jugosllavi t'i njehë të drejtën për formimin e një republike siç janë gjashtë të tjerat në RSFJ.

Për të arritur gjer tek ky qëllim, Lëvizja do të shërbehet me metoda të ndryshme të luftës që ia lejon etika revolucionare dhe që janë të njohura në praktikën e luftërave të popujve për liri.

II

ANETARET, TE DREJTAT DHE DETYRAT E TYRE

1. Anëtarë të Lëvizjes mund të bëhen të gjithë shqiptarët në Jugosllavi dhe pjesa e tyre në botën e jashtme, të cilët kanë kaluar moshën 18 vjeçare dhe që pranojnë programin dhe statutin e Lëvizjes për Republikë.
2. Anëtarë është ai i cili pranon Programin e saj, që e ndihmon materialisht dhe që merr pjesë personalisht në një nga celulat e saj.
3. Anëtari ka për detyrë:
 - a) të ruaj dhe të luftoj për unitetin e Lëvizjes. Lëvizja nuk lejon ekzistimin e fraksioneve në gjirin e vet,
 - b) të zbatoj vendimet e Lëvizjes, të respektoj statutin e saj, të propagandoj traditat patriotike të popullit tonë. Ai gjithmonë duhet të veproj nga pozita revolucionare,
 - c) të ngrit teorikisht, të mendoj, punoj e jetoj si revolucionar dhe luftën për formimin e Republikës Shqiptare në Jugosllavi ta vej në plan të parë në të gjithë veprimtarinë e tij,
 - d) të forcoj lidhjet me masat, të jetë i drejtë, i ndershëm, i dashur për popullin, të jetë armik i mendjemadhësisë, karrierizmit, indiferentizmit dhe i frymës së komandimit kundrejt njerëzve,
 - e) të jetë propagandist, agjikator dhe mbrojtës i flaktë i qëllimit të Lëvizjes,
 - f) të jetë kritik, autokritik dhe të luftoj vetëkënaqësinë,
4. Anëtari ka të drejtë
 - a) të marrë pjesë në diskutimin e problemeve të luftës së Lëvizjes,
 - b) të kritikoj sjelljet e anëtarëve dhe veprimet e padrejta,
 - c) të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet udhëheqëse
 - d) t'u drejtohet për çështje të ndryshme me pyetje, kërkesa dhe propozime organeve udhëheqëse të Lëvizjes
5. Pranimi në Lëvizje bëhet në mënyrë individuale, pas një njohje të gjatë dhe të hollësishme.
6. Lëvizja anëtarëve të vet nuk u shpërndan librezë.
7. Anëtari ka përgjegjësi të madhe për njerëzit që pranon në Lëvizje.
8. Kur anëtari tre muaj rresht nuk merr pjesë në mbledhje ose nuk paguan kuotizacionin a anëtarësisë, celula duhet ta shqyrtoj qëndrimin e tij në mbledhjen e vet.
9. Kalimi i anëtarëve prej një celule në një celulë tjetër bëhet sipas rastit me udhëzime të organeve udhëheqëse të Lëvizjes.
10. Anëtari i Lëvizjes që vepron në shtete të ndryshme të botës nuk guxon të bien me sjelljet e veta në kundërshtim me ligjet e vendeve në të cilat vepron dhe as nuk guxon në asnjë mënyrë të përzihet në punët e brendshme të atyre shteteve.
11. Për faje e gabime të palejueshme anëtari përjashtohet nga Lëvizja.
12. Nëse verifikohet se përjashtimi ka qenë jo i drejtë, atëherë kthimin mund ta bëjë vetëm celula që ka miratuar përjashtimin.

III NDERTIMI

13. Parimi udhëheqës i ndërtimit organizativ të Lëvizjes është centralizmi demokratik. Kjo do të thotë:

- a) të gjitha organet zgjidhen nga poshtë lartë, nëpër tubime të ndryshme, në forma që do të gjenden më të përshtatshme, ashtu siç na i imponon veprimtaria në ilegalitet,
- b) organet udhëheqëse janë të detyruara që kohë pas kohe të japin llogari para celulave të Lëvizjes,
- c) organet bazë japin llogari para organeve më të larta.

14. Lëvizja ndërtohet në bazë të territorit (lagje qytetesh e fshatra), baza prodhimi (fabrika e kombine), në institucione të ndryshme (fakultete, shkolla të mesme, shoqëri kulturore etj.) dhe nëpër koloni të ndryshme shqiptare në mërgim.

15. Të gjitha problemet celulat i zgjedhin vetë por me kusht që zgjedhja e tyre të jetë në vijën e Lëvizjes.

16. Lëvizjen e udhëheq Komiteti Qendror, nën vartësinë e të cilit veprojnë të gjitha komitetet e degëve si në atdhe ashtu edhe në mërgim.

17. Komitetet e degëve të LRSSHJ, janë organe të cilat koordinojnë aktivitetin e disa celulave dhe janë të lidhura me KQ të Lëvizjes.

IV ORGANET

18. Organi më i lartë organizativ i Lëvizjes është Kongresi. Në kushtet ekzistuese të cilat Lëvizja i gjykon si të jashtëzakonshme nuk mund të flasim për intervale të caktuara kohe të thirrjes së Kongreseve. Aktualisht Lëvizja lidhur me këtë çështje do të thërras Kongreset në përputhje me zhvillimin e situatës.

19. Pas Kongresit, organi më i lartë është Konferenca e KQ.

V CELULAT

Themel i Lëvizjes janë celulat e saj të cilat ngrihen në të gjitha vendet.

20. Celulat lidhin masat e qytetit dhe fshatit me organet udhëheqëse.

21. Detyrat e celulave janë

- a) të zhvillojnë punë politike, ideologjike dhe organizative për zbatimin e programit të Lëvizjes, të vendimeve dhe direktivave të saj,
- b) të bëjë shpërndarjen e shtypit, ta zbërthejë atë dhe të forcojë influencën e Lëvizjes,
- c) të raportojnë për punën e tyre para organeve më të larta,
- d) të ngriten ideologjikisht dhe të ndihmojnë në ngritjen e rrethit ku veprojnë

VI MJETET FINANCIARE

22. Të ardhurat financiare përbëhen nga kuotizacionet e anëtarësisë.

23. Kuotizacionet mujore janë 5% e të të ardhurave mujore të anëtarit.

24. Anëtarët që nuk kanë rrogë të caktuar ndihmojnë sipas mundësive dhe u ndihmohet sipas mundësive.
25. Qarkullimi i mjeteve materiale nga poshtë-lartë dhe anasjelltas bëhet sipas rregulloreve që përpunohen për raste të veçanta.
26. Lëvizja pranon ndihma materiale e morale nëse ato janë të pakushtëzuara.

(Teksti i këtij Statuti, me ndonjë formulim të ndryshëm nga dorëshkrimet e mia të vjeshtës së vitit 1983, është botuar nga Faridin Tafallari; Terror-Dhimbe-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 219- 222)

Pas konflikteve të mëvonshme (nëntor 1983) rreth 17 shkurtit e 15 majit 1982, këshillën e Xhafer Shatrit që ta përmendim vetëm 15 majin, për hir të unitetit e kam quajtur të padrejtë. E vërtetë tjetër është se ky Statut i shkruar nga unë Xhafer Durmishi, nuk u shpërnda për diskutim në rrethe, me përjashtim të shokëve të Shtutgartit, dhe në asnjë mbledhje të vetme nuk u vendos në rend të ditës me arsyetimin se për me u shkrua Statuti e Programi i Lëvizjes, Kosovës i nevojiten tre djem hallall që e donë vendin më shumë se vehten. E në atë kohë djem hallall kanë qenë vetëm dy, djem dukat me nga 24 karatë.

23. LUFTËTARI MË BESNIK DHE I PABESI GJER NË FUND

Xhafer Shatri: "Me Ilazin (Ibrahim Kelmendin-shën i Xh. D.) mendoj se duhet ta lëmë kështu njëherë të mos i bëjmë zë fare, por ai njeri nuk guxon më kurrë të jetë aty ku e kemi zgjedhur, ai është **njeri i papërgjegjësi dhe gjer në fund i pabesë.**" (Letër Xhafer Durmishit, Faridin Tafallarit, Hasan Malës, si anëtar të Qendrës Ekzekutive, 7 qershor 1983)

Ibrahim Kelmendi: "Nga vizita "përtej gardhit" (Shqipëri-shën im) janë kthyer disa. Dua të them se më ka rënë të dëgjoj shumë gjëra të mira dhe të këqija. Por, tani po shkruaj për disa gjëra, pa qenë i sigurt në vërtetësinë e tyre. Përndryshe, lirisht mund të them se disa gjëra kanë turpëruar emigracionin punëtor, i cili në opinionin e atjeshëm gëzon respekt të lartë, sidomos rasti i turneut të Ansamblit... dhe pritja kanë bërë të veten. Kjo ka rëndësi të madhe.

Gjatë gjithë kohës me vizituesit ku ka qenë edhe familja e shokut Drini (Jusufit Gërvallës-shën im), bashkatdhetarët janë kënaqur që kanë patur ata në mesin e tyre. Por, sipas të gjitha gjasave, shoqja e shokut Drini, duhet t'u ketë folur disave se Ilazi (Ibrahim Kelmendi-shën im) është Davidi në radhët e LRSHJ-së, pra Iljazi i bënka të gjitha të këqijat... **Pastaj, Salihu (Xhafer Durmishi-shën im) na qenka luftëtari më besnik**, por Ilazi ia saboton punën..., kështu ngjashëm. Nuk kanë munguar edhe "argumentet". Ndër "argumentet" më të freskëta ka qenë edhe mosvajtja e bashkatdhetarëve të Shtutg. në vizitë, të cilët i kam penguar unë të mos shkojnë. Pa e zgjatur, – por të jemi në korent se kanë ndodhur gjëra shumë të këqija, për të cilat më gjerësisht doemos më duhet të shkruaj herën tjetër, – mendoj se shokët Salih e Fahri (Faridin Tafallari-shën im) duhet t'i shkruajnë shoqes për unitetin tonë (nëse mendojmë se e kemi, unë mendoj se e kemi siguruar maksimumin e unitetit të mundshëm, i cili do të rritet gjatë pune e lufte të përbashkët!) dhe ta sqarojmë më mirë, pasi disa gjëra, që unë mendoj se i kemi kapërcyer, nuk do të duhej të përsëriten. Ato do na dëmtojnë shumë, pasi në vizitë në të ardhmen do të shkojnë vazhdimisht bashkatdhetarë nga këndej dhe unë s'do të dëshiroja, – për këtë lypset edhe mendimi juaj, – të dëgjoj sërish gjëra si kësaj radhe. Edhe njëherë, bëjë propozim që shokët Salih e Fahri t'i shkruajnë shoqes së shokut Drini dhe ta sqarojnë, ose të kërkojnë nga ajo që për një kohë të mos bisedoj me vizituesit gjëra të ngjashme,

përderisa të mos kemi siguruar prova, më përkatësisht, përderisa të mos ketë prova se Iljazi ka bërë gjëra të këqija...

Po kështu, propozoj që shoku Salih t'i shkruan edhe për grupin rreth gazetës "Punëtorët", sidomos për kretenin Nuhi, që shoqja të jetë në korent. Atje nga disa vizitues të Mynihut janë futur disa "Punëtorët" dhe u janë shpërndarë kosovarëve, të cilat u janë mbledhur pastaj... Të gjitha këto janë me rëndësi të madhe, pasi gjëra të tilla mund të keqpërdoren shumë, andej për "vizitë" do të dërgohen edhe vegla nga kënde, të cilëve të tilla fjalë u duhen për të mbjellë përçarje. Nuk kishte me qenë e tepërt, që një letër e tillë, po u vendos të dërgohet, ta kishim kopje." (Letër Qendrës Ekzekutive, 25 gusht 1983)

24. RROFTË LRSHJ - LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

Ibrahim Kelmendi: "Në agun e 17 Janarit rivendosëm themelimin e Lëvizjes për Republikën e Kosovës." (Atentatet, f. 381)

I. K: "Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim." (Atentatet, f.434)

Jusuf Gërvalla: "Atje shihet se ku qëndron e vërteta për bashkimin e paarritur, e MEGJITHATË TË SHPALLUR SI AKT TË KRYER në thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!" (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbe-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 412)

Me përsëritje identike është i mbushur libri i Bedri Islamit, Lëvizja, Tetovë 2012, sipas motos së njohur: "Një gënjeshtër e përsëritur shumë herë ka gjasa të bëhet e vërtetë."

Në këtë kapitull kam marrë shprehje nga letrat e Ibrahim Kelmendit dërguar Qendrës Ekzekutive (udhëheqjes së Lëvizjes), në të cilat përmendet emri i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, i dalur nga bashkimet e vërteta të 17 shkurtit e 15 majit 1982. Letrat përfshijnë periudhën 4 maj 1983 – 19 mars 1984, dhe prej tyre i kam zgjedhur e renditur 60 raste.

Shprehjet nga pika 1-17 janë marrë nga letra e 4 majit 1983

1.

Pavarësisht nga shpjegimet sipërfaqësore, për radhët e LRSSHJ-së, duhet të vlejné normat morale, të cilat s'do lejojnë fare që morali të jetë i dobët dhe patriotizmi të bashkudhëtojnë e të bashkëjetojnë "as për një kohë"! (4 maj 1983)

2.

Bile, ruajtja e moralit sa nuk ka kaluar në mit. Edhe njëherë: mendimi dhe propozimi im është që ata që anëtarësohen në LRSSHJ-në duhet të kenë moral të pastër, po deshëm që LRSSHJ-a t'i dalë zot misionit të vet të shenjtë me sukses!

3.

Mu për këtë arsye, po sa të na ipet rasti, duhet t'i përkushtohemi (duhet të them propozoj t'i përkushtohemi) edhe çështjes së moralit në gjirin e LRSSHJ-së...

4.

I jap të drejtë vetes, duke kërkuar falje, se fjala Lëvizje është emër i përvetshëm - në kuptimin kur është në pyetje LRSSHJ-a!

5.

Me siguri që, secili prej këtyre opinioneve, në mënyrat e tyre, u intereson për lidhjet e mia me LRSSHJ-në, dhe jo vetëm për lidhjet e mia, por edhe të shokëve tjerë...

6.

Unë e di se mbahet konspirative lidhja e secilit me LRSSHJ-në, sigurisht edhe jotja, jo vetëm ndaj "opinioneve të ndryshme", por edhe brenda radhëve të LRSSHJ-së (dihet në cilat përmasa...).

7.

Sikur të shprehem, ashtu siç po e kuptoj, se çfarë më shkruaje, atëherë del se për lidhjet e të tjerëve me LRSSHJ-në "opinionet e ndryshme" ditkan.

8.

Ekziston edhe një mundësi tjetër, që të kuptohet kështu: nga dashuria që kanë individët (në rastin tonë dihet se për cilët individ është fjala) për Lëvizjen, duan të dinë për lidhjet e mia (të njeriut të dyshimt, thonë ata), që ta shpëtojnë LRSSHJ-në nga kjo e "keqe"..

9.

Kurse vet personazhet po guzojnë të hapin gojën duke u shitur si të LRSSHJ-së, bile me "përgjegjësi" në këto radhë. Këtë të fundit po ua mundëson qëndrimi yt pritës, në rastin konkret qëndrimi yt oportunist e "pritës" dhe marrja pas veti në takime e bisedime në rrethe të ndryshme, që provojnë t'u imponohen rretheve si të "dërguar" (me taktikë përfide, për të lënë që të vetëkuptohet...) e "autorizuar" nga LRSSHJ-ja.

10.

Dhe lidhjet e mia me LRSSHJ-në u duhet shumë nga fakti, se unë i njoh nga orët e para në mërgim...

11.

Po kështu, nëse të ka rastisur të dëgjosh se si "opinioneve të ndryshme" u kanë interesuar lidhjet e mia me LRSSHJ-në dhe ti s'u ke dhënë përgjigje të merituar, atëherë jo vetë që vlerësohet qëndrim oportunist, por është shkelje e rëndë disiplinore, e disiplinës parimore!

12.

Në fakt, luftën e fushatat nuk i bëjnë kundër personave, por kundër Lëvizjes, së cilës nuk guzojnë t'i shpallin luftë, përderisa të duan të bëjnë luftë nga pozita, sikur janë të LRSSHJ-së..

13.

E kur është fjala për LRSSHJ-në, që nuk është ndonjë grup lokal i kufizuar edhe në mundësi, atëherë familjarizmit duhet vuar shqelmin dhe të mos lejohet të ngre fare të kokë në Organizatën tonë....

14.

Në këtë rast konkret, vëllau është anëtar Klubi dhe jo i LRSSHJ-së. Si simpatizant që është, nuk kemi mundësi t'ia ndalojmë të mos jetë, përderisa LRSSHJ-a është pararoja e popullit.

15.

Ndërsa sa i përket anëtarësimit në LRSSHJ-në, kur jam pyetur nga shokët, kam thënë se nuk është në nivel për të qenë anëtar.

16.

Pa u zgjatur më shumë mbi marrëdhëniet familjare në aktivitetet patriotiko-revolucionare, më konkretisht në gjirin e radhëve të LRSSHJ-së, e cila do të duhej të diskutohej në ndonjë rast tjetër, po ndalem te "vizita e parë" në Rrethin e dys.

17.

Ndahem me përshëndetje revolucionare, duke të dëshiruar shëndet të mirë e punë të mbarë!

-PËR NJË REPUBLIKË SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

-RROFTË LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SOCIALISTE SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI! (4 maj 1983)

18.

-PËR NJË REPUBLIKË SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

-RROFTË LRSSHJ-a! (3 qershor 1983)

19.

Për mendimin tim do të duhej të kompletohet i tëri për t'u diskutuar e aprovuar, duke e shoqëruar me një material shoqërues-udhëzues, për mënyrat e diskutimit, të grumbullimit të vërejtjeve dhe propozimeve, që përfundimisht të studiohen dhe të nxjerret Programi dhe Statuti i LRSHJ-së.

-PËR NJË REPUBLIKË SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

-RROFTË LRSSHJ-a! (3 qershor 1983)

Shprehjet nga pika 20-32 janë marrë nga letra e 30 qershorit 1983

20.

Nëse anëtarët e LRSHJ duhet ta analizojnë "Platformën..." në fjalë, atëherë do vetëkuptohet se me pëlqim që LRSHJ-së është formuar ... (30 qershor 1983)

21.

Pastaj, kur kërkohet që "Platformës..." t'i bëhet vlerësim nga gjithë anëtarët e LRSHJ-së, vetëkuptohet se LRSHJ-a duhet t'ua siguron anëtarëve atë.

22.

Se duhet demaskuar kjo "organizatë", më përkatësisht ajo bandë njerëzish dallkaukë, as që do duhej të çfaqet ndonjë dilemë, pasi në veprimtari minuese e kësaj natyre, "në emër të LRSHJ-së", shihet edhe nga i verbëti dhe dëgjohet edhe nga i shurdhëti.

23.

Para se të ndërmerret fushatë demaskimi, do të lypsej edhe njëherë të kthehemi 'dokumenteve' (që përmendin ata – të 17 shkurtit), të cilat, mendoj dokumentat, duhet t'i ketë LRSHJ-a në dispozicion, që të ecim me hapa të sigurtë, pasi armiqtë kanë më së shumti sukses atëherë kur shfrytëzojnë lëshime e gabime, që ndonjëherë shpëtojnë.

24.

Por, as në këtë rast, nuk ka vend për hutim; derisa Lëvizja nuk formon vet sindikatë a organizatë tjetër, atëherë nuk do mend të thuhet se është kundër parimeve organizative nëse individët bëjnë "aventura", duke u thirrë "në emër të LRSHJ-së".

25.

Shpërndarja e "organit" "Punëtorët", është bërë nga një rreth i caktuar njerëzish (duke mos përjashtuar edhe ndonjë anëtar të LRSHJ-së, si rrjedhim i mashtrimit, nivelit të ulët të vigjilencës ose edhe të nivelit të ulët organizativ...), të cilëve disa herë ua kemi zënë emrat, si intrigantë, përçarës, "thash e themgji", fodullë, dezorientues, etj., pse jo duke u thirrë në "intelektualizmin" e tyre, për t'i dirigjuar punëtorët, duke lënë të kuptohen se janë të "ngarkuar nga LRSHJ-a".

26.

Bile, do të më duket fare e pakuptueshme nëse mbi shpërndarjen e materialit në fjalë nuk janë porositur së paku anëtarët që të mosshpërndarë, duke i bërë me dije ata se nuk është nga LRSHJ-a.

27.

Propozimi tjetër do të ishte që në këtë numër të ZK të botohet së paku një sqarim i vogël, ku do të thuhej se materialet që kanë dalë në qarkullim nga "OSBPK" nuk kanë të bëjnë me LRSHJ dhe "dokumenta" në të cilët ata thirren, nuk ekzistojnë.

28.

Në vazhdim do të duhej të shkruhej: Qëndrimet e LRSHJ-së lidhur me të gjitha këto do t'i bëhen të njohura së shpejti opinionit.

29.

Shumë herë, edhe kur kemi patur prova për punën minuese e dezorientuese, sikur me qëllim bëheshim qorra e të shurdhër, me shpresë se nuk janë siç po veprojnë dhe se do mësohen të ecin mbarë, për t'u inkuadruar në radhët e LRSHJ-së, që të "rriten" ato.

30.

Këtë më së miri e shpjegon mungesa e Programit dhe Statutit të LRSHJ-së, konturat e të cilave u botuan në nr. e fundit të ZK, që të hapet diskutimi i anëtarëve dhe në fund, përfundimisht të hartohen e aprovohen. Edhe në këtë drejtim nuk më ka rënë asnjë aktivitet përkatës te anëtarët.

31.

Mbi shumë çështje nuk kemi teori të çartë përkatëse, ta zëmë sistemi shtetëror jug. dhe Republika Shqiptare; punësimi në vend dhe Republika Shqiptare (çfarë propozimi përkatës ka LRSHJ-a lidhur me punësimin në Kosovë, duke i kthyer të gjithë mërgimtarët, që dëshirojnë të kthehen); borxhet ndaj botës dhe obligimet e Republikës Shqiptare (pasi shumë borxhe janë marrë në emër të investimeve në ekonomi e bujqësi në Kosovë, por nuk dihet fare ku janë "avulluar"...); zhvillimi i kulturës kombëtare në Republikën Shqiptare; qëndrimet e qarta të LRSHJ-së ndaj kolonistëve, të cilët edhe sot e kësaj dite janë në nivel të misionit për të cilin janë sjellur...

32.

– PËR NJË REPUBLIKË SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!
– RROFTË LRSHJ--a! (30 qershor 1983)

33.

PËR NJË REPUBLIKË SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!
(Suedi, më 25 gusht 1983)

34.

Parollën që përdora në fillim, të cilën e kam përdorur edhe në letra të tjera, a është e drejtë? Mos kishte me qenë edhe më e drejtë PER REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI! Ose, që të dya nuk duhet të praktikohen fare dhe përse. (Suedi, 25 gusht 83)

Shprehjet nga pika 35-49 janë marrë nga letra e 10 tetorit 1983

35.

PËR NJË REPUBLIKË TË SHQIPTARËVE NË JUGOSLLAVI!
RFGJ., më 10 tetor 1983

36.

Për të luajtur rolin e vet Organi ynë, atje ku nuk mund të mbërrijnë militantët e LRSHJ-së, duhet të shkruhet mbi qëndrimin "pritës" në këtë situatë.

37.

Është e domosdoshme të dimë t'i themi popullit atë që kërkohet nga ne, përndryshe duhet pranuar se nuk jemi në nivel të përgjegjësisë, përkatësisht LRSHJ-a nuk ka asij militantë që ta ngrisin në nivel të Pararojës, me plotë kuptim të fjalës.

38.

Nuk ka nevojë të thuhet se në këto rrethana militantët e LRSHJ-së, pavarësisht nga përgatitja, nuk do mbërrijnë të kenë ndikim në të gjitha anët e atdheut, përkatësisht nuk do të mbërrinë aq shpejt organizimin e radhëve të veta.

39.

Atëherë i mbetet Organit të zavendësoi, pjesërisht, këtë pamundësi, që organizimi të bëhet nga vetvetja, së pari duke rritur bindjen se organizimi është i domosdoshëm dhe se duhet të organizohen, edhe nëse nuk janë në lidhje të drejtë për drejtë me LRSHJ, përmes militantëve, pasi në rreth mund që nuk është formuar ende komiteti i rrethit....

40.

Me kalimin e kohës, hiç të gjatë, në punë do të gjendeshin kontaktet, për t'u "shkrirë" nga grupet në vete, ose nga grupet e celulat e Lëvizjes, të organizuara nga vetvetja, në radhët e LRSHJ....

41.

E për t'ua ardhur në ndihmë atyre që organizohen në vete në rrethe deri sa të kenë lidhur kontakte me radhë të LRSHJ, duhet që taktika të shtrohet në shkrimet e Organit, deri në përmasat sa të mos damtohet praktika e përgjithshme e revolucionit.

42.

Me popull me vetëdije dhe mirë të informuar, mund të praktikosh taktikën më të suksesshme në shërbim të strategjisë, duke arritur fitore me sakrifica sa më pak që të jetë e mundshme.

E kjo është një ndër detyrat kryesore të Pararojës - LRSHJ!

43.

U zgjata ca në mendime të përgjithësuar, duke dashur të kontriboj që skeleti i Organit të LRSHJ të bëhet skelet i një organit, siç i takon roli, kur është Organ i pararojës së një populli.

44.

Shoku Xhemë, sigurisht, jo vetëm që mendon, por është duke bërë punën në redaktim të ZK, prandaj, me eksperiencën që po siguron, mund që ka mundësi t'i përkushtohet punës që të redakton një ZK, tamam Organ të LRSHJ, që çdo herë rritë kualitetin – për t'i dalur zot misionit që i është ngarkuar.

45.

Pse jo, mund të përmirësohet secili që me vetëdije të ulët bënë gabime, mund edhe të mëdha, duke u bindur se ka qenë në rrugë të gabuar, kundër interesave të çështjes kombëtare. Këtë rol duhet ta luan LRSHJ; që t'i ndihmon të gabuarit. ...

46.

Për këtë arsye, jam i mendimit, pa patur nevojë të humbim kohë për ta bindur njëri-tjetrin, të presim të jap prova të tjera më serioze, që gjithashtu nuk duhet të na detyrojnë që ta përqafojmë aq shpejt; për veprimtari të mbarë kombëtare a fushë të gjerë, që s'e ka monopolizuar LRSHJ.

47.

Ai mund të kontribuon, por nuk kemi nevojë t'i japim shansën që pas një kohe të komprometon, përkatësisht të provon komprometimin e LRSHJ.

48.

Të mendojmë ca me përgjegjësi dhe ndoshta mos jemi duke treguar oportunizëm të pa tolerueshëm, ose, përfundimisht duhet të vendosim që secili të ecë në rrugën e tij, ata me "Lëvizjen..." e tyre, kurse ne me tonën, duke sqaruar lexuesit për të gjitha. Sikur po më duket se dëshirojmë të bëjmë politikë arriviste, duke dashur që LRSHJ, në vend të pararojës, të bëjë manovrime politike me dreqin e të birin...

49.

Propozoj gjithashtu që shoku Salih të tregon se si ka shkuar Mbledhja në Bielefeld, ku është treguar oportunizëm më i ulët se në rastet tjera; aty Ganiu i ka përsëritur ato që ka thënë diku tjetër, duke mos folur së paku që t'ju jepet të kuptojnë pranishmëve se ato që ai, Ganiu i ka thënë, nuk janë mendime që aprovon LRSHJ. (10 tetor 1983)

Shprehjet nga pika 50-57 janë marrë nga letra e 11 janarit 1984

50.

PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

51.

Për Organin e LRSHJ-së, "Zëri i Kosovës", besoj që janë dhënë vlerësimet dhe është thënë e gjithë ajo që është dashur të thuhet....

52.

Për këtë arsye do propozoja që përmes Organit të thirren të gjithë militantët e LRSHJ-së për t'i shpreh mendimet, për t'i dhënë propozimet, ose për të formuluar variantet e tyre për Programin e LRSHJ-së.

53.

Pastaj, kush dinë se nga po vijnë ndihmat, në mënyrë që me ata që ndihmojnë, të bashkëpunohet më afër, pasi gatishmëria për të ndihmuar tregon shumë për nivelin e vetëdijes, kuptohet edhe të aftësive për të milituar pastaj në radhët e LRSHJ-së.

54.

Nëse ka ndonjë anëtarë të organizuar në nivel, nuk di çka e mban atë të lidhur për LRSHJ-në.

55.

Ata pastaj keqpërdorin atë që bashkatdhetarëve tjerë t'ju shesin taraf, se ja ata na qenkan me patriotët në rreth, ke të cilët LRSHJ-a ka më së shumti besim dhe jo ju.

56.

Mendoj se autoriteti i LRSHJ-së të bashkatdhetarët ka qenë i madh, nga rrjedh se shumë janë që do dëshironin të gjenin format e mënyrat për të kontribuar më shumë, meqë janë bukur të qartë se vetëm duke qenë të organizuar sa të japin atë që pritet nga ta dhe jo në mënyrë stihike e spontanisht.

57.

Nuk di sa jemi duke u përgatitur për përkujtim të 2-Vjetorit të rënies së shokëve. Nëse mund të mbërri (sigurisht që më me rëndësi do të ishte të kem kohë për shkrime të tilla), do shkruaj diç për atë mbrëmje. Do ishte e nevojshme që të gjejmë çka për të pagëzuar me emrat e shokëve. P.sh., do më dukej e arsyeshme që në kuadër të LRSHJ-së të themelojmë Ndërmarrjen botuese, duke e pagëzuar me emrin "Vëllezërit Gërvalla". Kështu edhe me emrin e shokut Kadri do duhej të pagëzonim diç. (11 janar 1984)

58.

PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI! (17 janar 1984)

59.

PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI! (19 janar 1984)

60.

PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI! (19 mars 1984)

25. THEMELET E PROGRAMIT

Qarkorja e mëposhtme është shkruar nga Ibrahim Kelmendi
(Shokëve të QE – për diskutim, përmirësim e aprovim)

QARKORE

Po afrohet 2-Vjetori i formimit të LRSHJ-së dhe ende nuk kemi Program Politik e Statut të Organizatës sonë. Mungesa e tyre po vështirëson veprimtarinë, njëherit po kushtëzohen gabimet. Fajin për mungesë të tyre duhet ndarë të gjithë, nga baza e gjer në Komitet Qendror. Lehtësim kemi vetëm kur marrim parasysh rrethanat, të kushtëzuara nga ilegaliteti i thellë, nga vrasje e arrestimet, si dhe nga vështirësitë që sjell me vete Bashkimi.

Tani, të gjitha komitetet e celulat në rrethe, si dhe të gjithë militantët e LRSHJ-së, duhet të fillojnë nga diskutimet – të japin propozime e mendime, nga do dali

përfundimisht Programi e Statuti i Lëvizjes. **Themelet e Programit** duhet të jenë Komunikata mbi Bashkimin (lëshuar në "Zëri i Kosovës", nr. 1, 1982), si dhe kërkesa e mirëfillta të mbarë popullit, të vulosura me gjak e sakrifica dhe të njohura tani për mbarë botën. Në ndihmë duhet marrë edhe variantin e kontureve të Programit (të botuara në ZK, nr. , 1983).

Diskutimet le të fillojnë menjëherë, për të mos i vonuar rezultatet.

Gjatë diskutimeve duhet të mbizotëron fryma patriotiko-revolucionare, duhet të merren parasysh të gjithë faktorët, nga të cilët varet shumë se çka do kërkojmë, si do kërkojmë dhe si do fitojmë. Fryma e vëllazërimit me popujt liridashës të Jugosllavisë e të botës nuk guzon të vihet në dyshim – populli ynë liridashës ka dashur e çmuar të gjithë popujt liridashës të botës, kurdoherë, duke ua dëshiruar lirinë...

Është momenti të tregohet pjekuria e mençuria patriotiko-revolucionare, vetëdija ideologjike e politike, si dhe historike, shpirti i internacionalizmit, i durimit revolucionar dhe sakrificës, edhe të jetës, kur e kërkon çështja e popullit e atdheut – liria dhe të drejtat. Nuk guzojnë të na i errin sytë shovenizmi, revanshizmi – këto duhet luftuar, së pari në radhët tona, në gjirin e popullit tonë!

Të tregohemi bijë e bija të popullit, t'i dalim zot misionit e çështjes, ashtu siç kërkohet nga populli e historia!

Komitetet, celulat e militantët e LRSHJ-së në botën e jashtme, pos diskutimeve, le të fillojnë nga fushata për grumbullimin e të gjitha adresave të bashkatdhetarëve në botën e jashtme, të anëtarëve të familjes, të fëmijëve në shkolla dhe jashtë, çfarë statusi (punëtor i "përkohshëm", i migruar në Turqi e gjetiu, azilant, etj.). Këto adresa, po që se grumbullohen me sukses e shpejt, pos tjerash ndihmojnë për të dhëna statistikore, meqë armiku po fsheh të dhënat e vërteta.

Detyrë e përhershme është që të zgjerojmë, kordinojmë e forcojmë radhët e LRSHJ-së, për t'i dalur zot me sukses misionit!

Rezultatet e diskutimeve duhet të jenë dhënë më së voni gjer në fund të shkurtit, 1984. Kurse fushata për grumbullimin e adresave duhet të vazhdojë çdo herë.

– PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

– LAVDI TË RËNËVE PËR LIRI E TË DREJTA TË POPULLIT E ATDHEUT!

– RROFUSHIN POPUJT LIRIDASHËS TË MBARË BOTËS!

– RROFTË LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

Më x Janar 1984

Komiteti Qendror i LRSHJ-së

(e shkruar nga Ibrahim Kelmendi)

26. NEGLIZHIM I RËNDËSISË AQ PARIMORE

Xhafer Durmishi: "Sa i përket Statutit të përgatitur nga ana ime kam këto vërejtje; duhet shtuar definimin e saktë se kush është, mund të quhet anëtarë i Lëvizjes, dhe një nen të ri që ka të bëjë me sjelljet e anëtarëve të Lëvizjes që veprojnë në shtetet e ndryshme, të cilët nuk guxojnë të bien në kundërshtim me ligjet e vendeve në të cilat veprojnë. Pastaj vërejtjen tjetër, në kapitullin e parë që ka të bëjë me datën e formimit të LRSHJ. Më 10 korrik 1983, Uka më tha se do të ishte shumë mirë në Komunikatë ta kishim shënuar vetëm 15 majin, pasi fraksionistët e PKMLSHJ nuk do të mund të qëndronin shumë, pasi kryesisht ata po thirren në 17 shkurtin. Duke u nisur vetëm nga ai qëllim dhe sidomos kur ka qenë në pyetje fraksioni që u shërbye me metoda shumë të ulëta mua më është dukur e arsyeshme dhe ky ka qenë shkaku kryesor që unë në atë statut e kam shënuar datën e 15 majit. Tani Mërgimi thirret në të njejtën mënyrë si Uka se qëllimi të shënohet 15 maji ka për qëllim ta devijoj vijën për Republikë për të cilën kemi

vendosur më 17 shkurt. Unë nuk ju kam kushtuar vëmendje të duhur këtyre gjërave, sepse për natyrën time nuk më janë dukur gjëra të dorës së parë. Pasi çështja është shkruar kësisoji, atëherë pavarësisht se si do të shprehemi as 17 shkurti nuk mund të fshihet pasi është një fakt, kur janë bërë bisedime dhe është vendosur, çka është më kryesorja, emri i organizatës të cilës më 15 maj nuk iu ndryshua asnjë pikë dhe asnjë presje. Sido që të jetë unë nuk jam për atë që të bëhet objekt diskutimi kjo çështje. Faktet historike mbeten fakte, unë jam për atë që me ato të merret historia." (Letër Qendrës Ekzekutive, 3 janar 1984)

Ibrahim Kelmendi: "Në përfundim të letrës shoku Salih (Xhafer Durmishi) na shkruan për datat 17 shkurt apo 15 maj, duke u ndalur prapë te 'allashvereshet' e rëndomta që po zhvillohen zakonisht me këto dy data, se nuk na qenkan për natyrë të tij, të dorës së parë, **sikur më duket neglizhim i rëndësisë aq parimore.** Kurse me data që ende je në to, do të thoja për rastin konkret, nuk ka si të merret historia. Në këtë rast kontestuese është se si të shkruhet në Program Politik, përkatësisht cila datë – dhe kjo ka rëndësi të madhe, pasi ndryshimi i datave përcjelllet me shkelje të Komunikatës së lëshuar me rastin e Bashkimit. Unë jam për atë, nëse duhet të vendoset ndonjë datë në Program Politik, atëherë të mbetet ashtu si është në Komunikatë." (Letër Qendrës Ekzekutive, 11 janar 1984, faqe 7)

27. DUHET PËRFUNDMISHT TË INFORMOHEMI

Ibrahim Kelmendi: "Gjatë takimeve që kishim, disa herë u sjellën bisedat në mes teje e shokut Zeqë. Lidhur me atë takim, mendoj se duhet të informosh, pak më shumë se sa i ke shkruar "heroit". Them kështu pasi disa fjalë shpëtuan gjatë fjalosjes mes teje e shokut Ujkan, prandaj, pos për arsyerave të tjera, edhe të mos lejohet mundësia për manipulim me fjalët që nuk janë incizuar as mbajtur shënime. Sidomos, do ndihmonte shumë informimi yt, pasi, me gjasë, vetëm ti je ndër të gjallët, që mund të informosh mbi bisedimet, ashtu siç janë zhvilluar.

Edhe shokut Salih (Xhafer Durmishit-shën im) i kam shkruar më heret, se **duhet përfundimisht të informohemi se si kanë shkruar bisedimet e 17 shkurtit dhe 15 Majit, por ai nuk e ka marrë mundin.** Prapë, edhe mes nesh është kontestuese kjo çështje, për të cilën nga shkruan shoku Salih në letrën e 3 janarit të këtij viti, duke u thirrë edhe në letrën që i ke shkruar, ose keni biseduar. Duhet njëherë e qartë, sidomos ju pjesëmarrësit e bisedimeve, të merrni qëndrim prej patriotëve revolucionarë, që ta thuani të vërtetën e plotë, dhe jo të përgjysmoni, duke lënë mundësinë për manipulime e keqkuptime." (Letër Qendrës Ekzekutive dhe Sabri Novosellës, 17 janar 1984)

28. DALIN NGA KOMUNIKATA PËR BASHKIM

Në takimin e mbajtur më 3 (tre) mars 1984 në Gjenevë, pjesëmarrësit e këtij takimi deklarojnë:

jemi autorizuar që në emër të organizatave të mëparshme, që u shkërinë në LRSHJ, përkatësisht në emër të anëtarëve të Komitetit Qendror brenda, - që në pamundësi nuk po mund të takohen, - dhe në emër të anëtarëve të Komitetit Qendror jashtë, të cilët për arsye shëndetësore e teknike nuk mund të marrin pjesë, të marrim të gjitha vendimet e mundshme e të nevojshme në emër të tyre.

Vendimet që marrim ne pjesëmarrësit e këtij takimi, me shumicë absolute votash, janë të plotëfuqishme për tërë LRSHJ,

përderisa ato përputhen me vendimet që dalin nga Komunikata për Bashkim (ZK, nr.1, 1982). Ata që nuk u përmbahen vendimeve që do marrim do të marrin mbi vete përgjegjësinë dhe pasojat.

Në takimin e mbajtur më 3 (tre) mars 1984 në Gjenevë, pjesëmarrësit e këtij takimi deklarojnë:

jeni të autorizuar që në emër të organizatave të mëposhtme, që u shprehën në LRSHTJ, përkatësisht në emër të anëtarëve të Komitetit Qendror Brenda, - që në pavarësi nuk po mund të takohen, - dhe në emër të anëtarëve të Komitetit Qendror jashtë, të cilët për arsye shëndetësore e teknike nuk mund të marrin pjesë, të marrin të gjitha vendimet e mundshme e të nevojshme në emër të tyre.

Vendimet që marrim në pjesëmarrësit e këtij takimi, me shumicë absolute votash, janë të plotëfuqishme për tërë LRSHTJ, përderisa ato përputhen me vendimet që dalin nga Komunikata për Bashkim (ZK, nr.1, 1982).

Ata që nuk u përmbahen vendimeve që do marrim do të marrin mbi vete përgjegjësinë e pasojat.

Dokumenti u nënshkruajmë me emër e mbiesh.

1. *Facidin Hollar' Jardi*
2. *Xhafer Shatri Shatri*
3. *Xhafer Dermishi, Xhaferi*
4. *Ibrahim Kelmendi Kelmendi*

Dokumenti u nënshkrua nga katër veta, të pranishëm në këtë takim.

Dokumenti i formular nga Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi, në mbledhjen e 3 marsit 1984 në Gjenevë. Dorëshkrimi është i Ibrahim Kelmendit.

Dokumentin e nënshkruajnë me emër e mbiemër:

- 1. Faridin Tafallari, nënshkrimi*
- 2. Xhafer Shatri, nënshkrimi*
- 3. Xhafer Durmishi, nënshkrimi*
- 4. Ibrahim Kelmendi, nënshkrimi*

Dokumenti u nënshkrua nga katër veta, të pranishëm në këtë takim.

Ibrahim Kelmendi: "Data e krijimit të qendrës ekzekutive ndoshta është pikërisht 15 janari 1983, por e shuarjes së saj nuk besoj të ketë qenë 3 marsi 1984. Informatën për shuarjen ju mund ta keni marrë nga "libri" i "trashëgimitarit" të atëdhetarit të madh Jusuf Gërvalla, pra të Zotëri Xhafer Durmishit, sepse, meqë me 3 mars 1984 ai paskësh dhënë "dorëheqjen" nga qendra ekzekutive, atëherë menduaka se edhe ajo është shuar!" (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.135)

Dokumenti i lartpërmendur u përgatitë me iniciativën e Xhafer Shatrit dhe Ibrahim Kelmendit dhe u shkrua në dorëshkrim nga Ibrahim Kelmendi dhe u nënshkrua nga katër të pranishmit. Me këtë pushoi së ekzistuari Qendra Ekzekutive, e formuar më 15 janar 1983 në Ludwigsburg. Forumi i ri ishte planifikuar të quhej KOMITET QENDROR, ndërsa identifikimi e referimi tek ky Komitet Qendror në korrespondencën tonë do të bëhej me emrin "**DUKAGJINI**".

Ibrahim Kelmendi: "Pasi nuk patëm kohë për të biseduar, propozoj gjithashtu që artikujt që kanë shpërndarë Mërgimi e Musa Hoti, duke keqpërdorur simpatizantë të Lëvizjes, që mu më kanë rënë në dorë gjithsejt tetë, të mos pranohen se i ka nxjerr **Dukagjini**, "në emër të të cilit" janë shpërndarë." (Letër Faridin Tafallarit, Xhafer Shatrit e Xhafer Durmishit, 19 mars 1984)

Letra e 19 marsit 1984, është letra parë dhe e fundit që kam marrë në cilësinë e anëtarit të "Dukagjinit".

=====

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit

01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013

17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: *“Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror.”* (14 janar 1981)

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën “Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi”. Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

XHAFER DURMISHI-SKENDERI Prill 2012-Shkurt 2026